



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 758 Akti

Nr. 737 Vendimi
Tiranë, më 13.2.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Teo Jacobs, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 9.2.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Majlinda Tosku**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Majlinda Tosku, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Majlinda Tosku është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të saj si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Majlinda Tosku i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2021, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli (relatore).
3. Nga Komisioni janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisioneren Etleda Çiftja dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.
5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Majlinda Tosku, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.
6. Në datën 23.1.2024, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri në datën 2.2.2024.
7. Në datën 1.2.2024, subjekti ka paraqitur një kërkesë për shtyrje të afatit për shkaqe objektive dhe ka paraqitur dy raporte mjekësore të sajat. Me vendimin nr. 3, datë 5.2.2024, Komisioni vendosi të pranojë kërkesën e subjektit duke e shtyrë afatin deri në datën 8.2.2024, ora 11:00 dhe të njoftojë se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 9.2.2024, në orën 10:00.
8. Në datën 9.2.2024, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti ishte paraqitur pa përfaqësues ligjor.
9. Në datën 13.2.2024 u shpall vendimi për subjektin e rivlerësimit Majlinda Tosku.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe

ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

VLERËSIMI I PASURISË

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e ndihmës ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 7.6.2016 dhe ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë *Vetting* në datën 29.1.2017 me nr. indeksi ***.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Majlinda Tosku ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 10.4.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.4.2018, në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të remë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku.

17. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

18. Gjendja e llogarisë rrjedhëse të pagës pranë BKT-së në datën 28.1.2017 në shumën 492.00 lekë. Shuma neto 492.00 lekë. Zotërues: 100 %. Burimi i krijimit: paga. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Gjatë hetimit administrativ BKT-ja konfirmon llogarinë e pagës së znj. Majlinda Tosku, si dhe me gjendje në datën 28.1.2017 në shumën 492 lekë¹. Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin bankar.

19. Gjendja e llogarisë rrjedhëse të pagës pranë Credins Bank në datën 28.1.2017 në shumën 147,590.60 lekë. Shuma neto 147,590.60 lekë. Zotërues: 100 %. Burimi i krijimit: ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.7.2014. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Gjatë hetimit administrativ Credins Bank konfirmon llogarinë e pagës së znj. Majlinda Tosku me gjendje në datën 28.1.2017 në shumën 147,590.60 lekë². Nga veprimet bankare konstatohet se në datat 9.12.2016 dhe 14.6.2017 janë kredituar në llogari përkatësisht shumat 1,165,800 lekë dhe 442,009 lekë nga shoqëria “****” sh.p.k. për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.7.2014. Përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin bankar.

20. Gjendje *cash* në shumën 1,500,000 lekë. Burimi i krijimit: një pjesë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.7.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, si dhe një pjesë të ardhura nga pagat. Shuma neto 1,500,000 lekë. Zotërues: 100 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

20.1. Në deklaratën *Vetting*, për të provuar të ardhurat për krijimin e gjendjes *cash*, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

- Vërtetimin nr. *** prot., datë 24.10.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për periudhën 1.2.2009 – 1.3.2015, që vërteton përfitimin në total të shumës 3.063.258 lekë.

- Vërtetim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nr. *** prot., janar 2017, ku rezulton se për periudhën qershor 2016 – dhjetor 2016 subjekti pa përfituar të ardhura nga paga në shumën totale 427,792 lekë.

- Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. ***, datë 29.7.2014 me palë paditëse Majlinda Tosku dhe palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, ku subjekti ka përfituar shumën 1,165,800 lekë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 19.11.2014. Nga të dhënat bankare të Credins Bank rezulton se shuma 1,165,800 lekë ka kaluar në llogarinë bankare të subjektit me përshkrimin “Ekzekutim i vendimit nr. ***, datë 29.7.2014”.

- Vendimin nr. ***, datë 25.3.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i formës së prerë, me palë paditëse Majlinda Tosku dhe palë të paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, nga i cili subjekti ka përfituar shumën 84,600 lekë. Kjo shumë ka kaluar në llogarinë bankare të subjektit në Credins Bank në datën 6.5.2016. Bashkëlidhur në dosjen e ILDKPKI-së gjendet urdhër shpenzimi nr. ***, datë 29.4.2016, për kalimin e vlerës 101,400 lekë në llogarinë e Zyrës Përmbartimore E. B. (81,600 lekë është vlera e vendimit të gjykatës + 3,000 lekë shpenzime gjyqësore + 16,800 lekë është tarifa e shërbimit përmbartimor). Shuma është derdhur në numrin e llogarisë në BKT të përmbartueses E. B., e cila më pas ia transferon znj. Majlinda Tosku.

¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2017, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.7.2017, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2022, në dosjen e Komisionit.

20.2. Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar me të ardhura të ligjshme gjendjen *cash* 1,500,000 lekë. Për këtë, Komisioni ka analizuar secilin nga burimet e krijimit të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si vijon:

a. Në lidhje me burimin e parë “të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.7.2014”. Nga veprimet bankare në Credins Bank rezulton se shuma 1,165,800 lekë është kredituar në datën 9.12.2016. Këtë shumë, në periudhën 9.12.2016 – 28.1.2017 subjekti e ka përdorur: (i) pjesërisht për të kryer pagesa/blerje të ndryshme në një total prej 217,269 lekësh; (ii) për tërheqje *cash* në një total prej 901,868 lekësh; si dhe (iii) si gjendje llogarie të mbartur në datën 28.1.2017 në shumën 147,590.60 lekë. Nisur nga shpenzimet në shumën 217,269 lekë dhe duke qenë se nga sistemi TIMS nuk ka të dhëna për udhëtime të subjektit në periudhën 9.12.2016 – 28.1.2017 dhe as të dhëna për investime në ndonjë pasuri, në përfundim të hetimit administrativ, shuma në total prej 900,000 lekësh është konsideruar se ka shërbyer si burim i ligjshëm për krijimin e gjendjes *cash* prej 1,500,000 lekësh.

b. Në lidhje me burimin e dytë “të ardhurat nga pagat e subjektit”, për të verifikuar mundësinë për kursime nga pagat e subjektit Komisioni ka kryer analizën financiare duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit për periudhën 1.2.2009 – 28.1.2017, si në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	1.2.2009 – 28.1.2017
Të ardhurat	3 575 650
Të ardhurat nga paga 1.2.2009 – 31.3.2015 DPA	3 063 258
Të ardhurat nga paga 1.6.2016 – 31.12.2016 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	427 792
Vendim gjykate nr. 1571, datë 25.3.2015, kaluar në bankë më 5.6.2016	84 600
Detyrime	10 300 000
Kredi në Credins Bank datë 17.5.2011	4 500 000
Kredi Fondi Besa datë 16.1.2009 300,000	300 000
Kredi Fondi Besa datë 25.5.2009 2,500,000	2 500 000
Kredi Fondi Besa datë 12.4.2013 3,000,000	3 000 000
Shpenzime	28 924 935
Shpenzime jetike 1.2.2009 – 31.12.2016 (për një person)	1 359 889
Shpenzime TIMS	353 275
Paguar nënës për blerje apartamenti datë 2.5.2011 (kontr. premtim shitjes)	3 000 000
Pagesa kredie te Fondi Besa	7 868 147
Pagesa kredie për vëllezërit	384 500
Pagesë kredie në Credins Bank datë 5.3.2014	5 659 124
Kredi të tërhequra nga bankat	10 300 000
Pasuri	148 083
Ndryshim likuiditeti në bankë	148 083
Mundësia për kursime <i>cash</i>	-15 197 368

20.3. Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të kursyer nga pagat. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme likuiditetin *cash* prej 600,000 lekësh, pjesë përbërëse e likuiditetit prej 1,500,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

20.4. Në parashtrimet e veta lidhur me këtë konstatim subjekti ka deklaruar se: *“E vetmja analizë financiare analitike është tabela në faqen 4 të Rezultatit të hetimit, analizë ku ndoshta nga pakujdesia nuk është përfshirë shuma prej 1,165,800 lekësh e përfituar nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 29.7.2014. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 19.11.2014. Nga të dhënat bankare të Credins Bank rezulton se shuma prej 1,165,800 lekësh ka kaluar në llogarinë time bankare me përshkrimin “Ekzekutim i vendimit nr. ***, datë 29.7.2014”.*

20.5. Siç vërehet, subjekti, në mënyrë të pakuptueshme dhe të pajustificueshme, parashtron se ndoshta nga pakujdesia Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare shumën 1,165,800 lekë të përfituar nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 29.7.2014, ndërkohë që në rezultatet e hetimit administrativ qartësisht Komisioni ka pasqyruar këtë fakt duke verifikuar edhe mënyrën sesi subjekti e ka përdorur këtë shumë dhe duke konsideruar shumën 900,000 lekë të përfituar me vendimin e gjykatës si pjesë përbërëse të likuiditetit *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* prej 1,500,000 lekësh.

20.6. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim/parashtrim në lidhje me balancën negative prej -15,197,368 lekësh të rezultuar nga analiza financiare për periudhën 1.2.2009 – 28.1.2017, e cila ka afektuar pamundësinë për justifikimin e shumës prej 600,000 lekësh e mbetur nga likuiditeti *cash* prej 1,500,000 lekësh, për të cilën nuk ka dhënë gjithashtu ndonjë parashtrim. Sa i takon balancën negative prej -15,197,368 lekësh, në përfundim të procesit ndryshoi në -12,197,368 lekë pasi Komisioni vlerësoi se shuma 3,000,000 lekë nuk është paguar nga subjekti sipas kontratës së premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2011, duke e konsideruar atë si kontratë fiktive (arsyetuar hollësisht në paragrafin 36 e vijues të këtij vendimi). Pamundësia financiare për justifikimin tërësisht të likuiditetit *cash* prej 1,500,000 lekësh dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit pasuror gjatë procesit të vendimmarrjes.

KONSTATIME TË TJERA

21. Në adresë të subjektit është paraqitur një denoncim nga shtetasi N. Ç. (në regjistrin e GJ. C. ka dy shtetas me këtë emër), protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.6.2020, i cili në mënyrë të përmbledhur ngre pretendime se:

- Subjekti është shkarkuar nga detyra si juriste në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për shkak të paaftësisë dhe se ka abuzuar për shkelje dhe shpërdorim detyre pasi ka përfituar shuma të konsiderueshme në mënyrë korruptive për blerje të vogla në tenderat e zhvilluara nga DPA-ja.

- Subjekti ka marrëdhënie të ngushta me gjyqtarin A. S., duke përfituar kështu favore për sa i takon çështjeve të saja gjyqësore, por edhe duke bërë rolin e sekserit gjatë kohës që ka punuar si ndihmëse ligjore me të në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- Subjekti ka pasuri të fshehur duke iu referuar një pasurie të regjistruar në emër të prindërve dhe 2 vëllezërve të subjektit, që është pallati 5 kate në mes të Tiranës, në Rrugën e *** pranë kinemasë “***”.

- Subjekti ka marrëdhënie abuzive me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ku luan rolin e sekserit për gjyqtarë të ndryshëm të kësaj gjykate, duke marrë përsipër çështje kundrejt shumave të ndryshme të parave. Për çështje që nuk kanë nevojë për avokat ajo i përgatit vetë kërkesëpaditë ose ia jep të vëllait, i cili në mënyrë fiktive luan rolin e avokatit, kur në të vërtetë është një strategji për të mbuluar përfitimet e saj nga punët e ndryshme aty.

- Subjekti shoqërohet me njerëz të implikuar në botën e krimit dhe të akuzuar për vepra të ndryshme penale.

Për të verifikuar pretendimet e mësipërme u kryen veprimet hetimore si vijojnë:

22. Në lidhje me punësimin e mëparshëm të subjektit, nga aktet në dosje³ rezultoi se:

- Subjekti është diplomuar pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në datën 31.1.2004.

- Në datën 2.2.2009, subjekti është emëruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe ka lidhur kontratë pune me afat 3-mujor me detyrën specialiste, arkiviste. Me vendimin nr. *** prot., datë 30.9.2010, është konfirmuar si nëpunëse civile në pozicionin e punës “Specialiste” pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore. Në vitet në vijim, kjo drejtori është suprimuar dhe i është bashkëngjitur një sektori tjetër, duke u krijuar një drejtori e re me emërtimin “Drejtoria e Dokumentacionit dhe e Marrëdhënieve me Publikun”, ku subjekti ka punuar në pozicionin e punës “Juriste”.

- Në datën 25.2.2014, me urdhrat nr. *** dhe nr. *** prot., të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave është urdhëruar “kalimi në listë pritje” për subjektin Majlinda Tosku, për shkak të suprimimit të vendit të punës. Duke mos u pajtuar me këtë vendim subjekti i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku ka kërkuar shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ dhe rrimërimin në vendin e mëparshëm të punës.

- Me vendimin nr. ***, datë 29.7.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (gjyqtar A. S.), lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 19.11.2014, gjykata ka vendosur detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave që t’i paguajë subjektin Majlinda Tosku pagën nga data 25.2.2014 dhe deri në datën e rikthimit të subjektit në vendin e mëparshëm të punës.

- Në datën 23.5.2014, ndërkohë që subjekti ka qenë në listë pritjeje, Agjencia e Prokurimit Publik ka marrë vendimin nr. *** me objekt “Propozim dhënie mase” për shkak të disa parregullsive të vërejtura në disa procedura prokurimi të monitoruara prej tyre. Në datën 18.9.2014, me vendimin nr. *** të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (Komisioni i Disiplinës) është marrë masë disiplinore ndaj subjektit Majlinda Tosku “*mbajtja 1/3 e pagës për një periudhë katër muaj*”. Duke mos u pajtuar me këtë masë disiplinore subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt shfuqizimin e të dyja akteve administrative.

- Në datën 25.3.2015, me vendimin nr. *** (gjyqtar A. S.) gjykata i shfuqizoi aktet administrative duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për t’i kthyer vlerën e mbajtur në masën 1/3 e pagës për 4 muaj subjektin Majlinda Tosku. Ky vendim është i formës së prerë duke qenë se nuk është ankimuar në Gjykatën e Apelit Administrativ.

- Referuar shkresës nr. *** prot., datë 14.2.2022, të dërguar nga ISSH-ja⁴, rezulton se subjekti ka qenë e siguruar pranë DPA-së deri në shkurt 2015. Në dosjen e ILDKPKI-së nuk ka informacion për mënyrën e largimit nga puna pranë DPA-së. Pas shkëputjes nga shkurti 2015, në muajin qershor 2016 subjekti ka filluar punë në pozicionin e punës ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht, ndihmëse e gjyqtarit A.S.

- Në pyetësin nr. 3 subjekti ka deklaruar se është larguar nga puna pasi ka përfunduar periudha e listës së pritjes dhe ka vënë në dispozicion kopjen e librezës së punës ku tregohet se ka filluar punë në datën 2.2.2009 pranë DPA-së në pozicionin e punës specialiste/juriste deri në datën 31.12.2012, që subjekti ka pasur ndryshim kategorie. Nga data 1.1.2013 subjekti ka pasur

³ Shihni aneksin nr. *** në dosjen ILDKPKI.

⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2022, dërguar nga ISSH-ja në dosjen e Komisionit.

ndryshim kategorie page në IV-A dhe ka vijuar të jetë e punësuar në pozicionin e punës specialiste/juriste pranë DPA-së deri në datën 1.3.2014, që subjekti ka kaluar në listë pritjeje. Nga data 1.3.2014 subjekti ka qenë në listë pritjeje deri në datën 1.3.2015, që e ka përfunduar atë.

- Nga shkresa kthim përgjigjeje e dërguar nga ISSH-ja është konstatuar se gjatë tre muajve, konkretisht, tetor-nëntor-dhjetor 2014 subjekti ka qenë e dypunësuar, sikurse rezultoi të jenë derdhur kontribute (sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në favor të saj nga një shoqëri private e regjistruar në QKB me NIPT *** dhe emër tregtar “****” sh.a., për të cilën subjekti nuk ka deklaruar të ketë qenë e punësuar dhe as të ketë përfituar të ardhura nga punësimi pranë kësaj shoqërie. Nga kontrolli i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit nuk rezultoi që ajo të ketë përfituar pagesë nga shoqëria private “****” për periudhën e punësimit tetor-nëntor-dhjetor 2014.

Sa më sipër, nuk është parë e domosdoshme kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore në lidhje me pretendimin për punësimin e mëparshëm të subjektit të rivlerësimit.

23. Sa i takon pretendimeve për marrëdhënie të ngushta me gjyqtarin A.S., gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranë të cilit më pas subjekti ka punuar si ndihmëse ligjore, i cili ka dhënë edhe dy vendime në favor të subjektit Majlinda Tosku, u verifikuan udhëtimet në sistemin TIMS, nga të cilat nuk rezultoi të kenë bërë udhëtime bashkë. Edhe për vëllezërit e subjektit nuk ka të dhëna për udhëtime me gjyqtarin A. S.

Në lidhje me një godinë pesëkatëshe të ndodhur në rrugën “**”, Tiranë**

24. Nga hetimi administrativ rezultoi se:

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile dhe si adresë vendbanimi *Njësia nr. ***, apartamenti nr. ***, në katin e *** të godinës ***kate, në rrugën “****”, Tiranë.* ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar: (i) *të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme në adresën e mësipërme;* (ii) *të ketë marrë me qira pasuri të paluajtshme në adresën e mësipërme;* (iii) *të ketë në posedim ose në përdorim pasuri të paluajtshme në adresën e mësipërme.*

- Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk e ka deklaruar pronësinë/përdorimin/posedimin e ndonjë pasurie të paluajtshme. Edhe në rubrikën “Nëse dispononi vendqëndrim tjetër”, subjekti nuk ka deklaruar ndonjë banesë.

- Në përgjigje të pyetësorit standard të datës 30.11.2021 subjekti ka deklaruar se që nga momenti që ka marrë detyrën e deri më sot ka banuar në shtëpinë e nënës së saj në adresën Njësia Bashkiake nr. ***, apartamenti nr. ***, në katin e *** të godinës *** kate, në rrugën “****”, Tiranë, për të cilën nuk ka paguar ndonjëherë qira dhe ka paraqitur certifikatën e pronësisë datë 19.9.2019 për pasurinë nr. ***, me sip. 138.4 m², në emër të nënës së saj D. T. Subjekti ka sqaruar se gjatë gjithë periudhës së deklaramit ka në përdorim një pjesë të apartamentit (sipërfaqen prej 68.4 m²) dhe që nga viti 2012 e në vijim pasuria posedohet nga vetë subjekti.

- Subjekti ka marrë disa kredi ku si kolateral janë vënë pjesë përbërëse të godinës pesëkatëshe (ndër to edhe pasuria nr. ***) dhe në llogari të saj kanë kaluar disa shuma të përfituara nga dhënia e tyre me qira (trajtuar në vijim).

- Në denoncimin e shtetasit N. Ç. pretendohet se subjekti ka pasuri të fshehur duke iu referuar pikërisht godinës pesëkatëshe.

Për të gjitha sa me sipër është bërë i domosdoshëm hetimi në lidhje me godinën pesëkatëshe, pasuria nr. ***, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

25. Në lidhje me origjinën e pasurisë dhe burimin e investimeve, nga Komisioni u kryen disa verifikime pasqyruar në mënyrë të hollësishme në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të të cilave rezultoi se:

i) Objekti pesëkatësh duket të jetë ndërtuar përgjatë viteve 2000 deri në vitin 2006 kur është aplikuar për leje legalizimi nga babai i subjektit (nuk ka të dhëna për punësimin e subjektit në vitet 2006 dhe 2007) dhe leja e legalizimit ka dalë në emër të nënës së subjektit D. T. në vitin 2011 (kur subjekti ka qenë juriste në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave). Pasi është regjistruar fillimisht e gjithë godina në emër të nënës së subjektit në vitin 2011, në vijim, nëpërmjet disa akteve noteriale, pronësia mbi pjesët përbërëse të saj ka kaluar në emër të nënës së subjektit dhe vëllezërve të saj.

ii) Subjekti ka deklaruar se objekti pesëkatësh është ndërtuar me kontribut të vëllezërve të saj, por nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar punësimin (me përjashtim të vëllait G. T. për të cilin ka vërtetuar punësimin si OPGJ për një periudhë dyvjeçare) dhe të ardhura të përfituara nga vëllezërit e saj.

26. Në lidhje me përdorimin dhe të ardhurat nga qiratë, pas verifikimeve u konstatua se:

26.1. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga apartamenti në pronësi të nënës ku ajo banon, pasuria nr. ***, me sip. 138.4 m², në një sipërfaqe prej 68,4 m² jeton ajo me dy fëmijët e saj, ndërsa pjesa e mbetur prej 70 m² është dhënë me qira dhe pagesat e bëra për vlerën e qirasë i kanë kaluar në llogarinë bankare të subjektit, pasi nëna e saj D. T. nuk ka hapur/poseduar asnjëherë llogari bankare në emrin e saj. Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur dy kontrata qiraje, konkretisht kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.7.2019 dhe kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2021, ku palë qiradhënëse ka qenë nëna e subjektit. Nga të dhënat bankare rezultoi se për kontratën e parë, në llogari të subjektit pranë Tirana Bank janë kryer pagesa qiraje në shumën totale 251,750 lekë, ndërsa për kontratën e dytë rezultoi se në Intesa Sanpaolo Bank janë kryer pagesa qiraje në shumën totale 400,000 lekë. Të ardhurat e qirasë janë tërhequr *cash* nga subjekti.

FSHU-ja ka konfirmuar se në emër të znj. D. T. figuron kontrata nr. ***, që i përket pasurisë nr. ***, duke informuar se kjo kontratë e hapur në datën 18.12.2006 faturohet që nga janari 2007 dhe ka ndryshim emri nga abonenti M. T. në D. T. në datën 26.9.2015⁵.

26.2. Në përgjigjen e Fondit Besa konstatohen edhe dy kontrata qiraje të tjera të lidhura nga nëna e subjektit me objekt pjesë përbërëse të godinës pesëkatëshe, për të cilat nuk u evidentuan kalime të qirave mujore në llogari të subjektit.

26.3. Në llogarinë e subjektit në Credins Bank evidentohet se për periudhën 10.11.2014 – 5.2.2016 ka në total 510,000 lekë kreditime me përshkrimin “Likuidim qira”. ILDKPKI-ja ka konstatuar: *Fshehje të të ardhurave të përfituara nëpërmjet qiradhënies, referuar kreditimeve në llogarinë e subjektit në Credins Bank, me përshkrimin “Likuidim qiraje”. Subjekti nuk ka deklaruar të ketë pasur pasuri të paluajtshme në pronësi.*

Nga verifikimi i llogarive të subjektit gjatë hetimit administrativ rezultoi se në Credins Bank janë kryer pagesa qiraje nga shoqëria “****” sh.p.k. për periudhën 10.11.2014 – 5.2.2016, në shumën 30,000 lekë/muaj dhe totali i paguar është 510,000 lekë. Të ardhurat e qirasë janë tërhequr *cash* nga subjekti. Duke qenë se ka pasur paqartësi se cila ishte pasuria e dhënë me qira, u pyet subjekti, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2 nuk ka qartësuar në lidhje me pasurinë konkrete të dhënë me qira dhe ka deklaruar se shumata e përfituara nga qiratë ajo nuk i ka deklaruar si të ardhurat e saj, pasi duke qenë se pasuria ka qenë në pronësi të nënës, edhe të ardhurat që janë përfituar nga dhënia me qira e kësaj pasurie i ka konsideruar si të ardhura të nënës së saj. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.11.2014, të lidhur midis nënës së saj dhe shoqërisë “****” sh.p.k., ku palët deklarojnë se kanë lidhur një kontratë qiraje dhe çmimi real që pala qiramarrëse do të paguajë çdo muaj është 35,000 lekë. Kjo deklaratë nuk ka të dhëna

⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2022, të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

për cilën pasuri dhe për cilin afat kohor është lidhur kontrata e qirasë. Por, subjekti deklaron se duke qenë se ka kaluar afati i ruajtjes së këtij tipi kontratash, referuar ligjit “Për noterinë” nuk ka mundësi ta sigurojë këtë kontratë. Është i pavërtetë ky deklaram i subjektit pasi sipas udhëzimit nr. 23, datë 7.12.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, afati i ruajtjes së kontratave të qirasë është 10 vjet pas afatit që dokumenti parashikon të ketë efekte juridike dhe, kur nuk e ka një të tillë, 10 vjet nga dita e regjistrimit të aktit, ndërkohë që deklarata noteriale është e datës 3.11.2014 dhe pagesat e qirasë i përkasin periudhës 2014 – 2016, pra brenda afatit 10-vjeçar të ruajtjes së kontratave.

Pasi është njohur me këtë konstatim, subjekti në parashtrime ka paraqitur një arsye të re të mosgjetjes së kontratës duke deklaruar se: “... *jam munduar të gjej kontratë qiraje në lidhje me këtë “gjetje”, por duke mos qenë palë kontraktore e kam të vështirë të përcaktoj kohën e lidhjes së kontratës dhe formën e saj sepse referuar nenit 803 të Kodit Civil, kontratat e qirasë mbi një vit janë të detyrueshme të bëhen në formë shkresore*”.

26.4. Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, subjekti ka vënë në dispozicion disa kontrata qiraje në të cilat ajo nuk ka qenë palë kontraktore. Nga të dhënat bankare nuk ka të dhëna që qiratë për këto kontrata të kenë kaluar në llogari të subjektit.

26.5. Në llogarinë bankare pranë BKT-së rezulton edhe një pagesë qiraje në shumën 25,500 lekë, në datën 2.8.2016, kryer nga S. J. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumentacion shkresor se kujt pasurie i përket kjo kontratë. Në parashtrimet e veta subjekti nuk ka dhënë asnjë deklaram apo dokument në lidhje me këtë konstatim, qëndrim i përsëritur edhe për konstatime të tjera, i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes.

26.6. Në përfundim të hetimit, në mënyrë të përmbledhur në lidhje me pasurinë nr. *, kati i dytë i godinës pesëkatëshe, ka rezultuar se:**

- Nëna e subjektit ka lidhur disa kontrata qiraje për pjesë përbërëse të godinës pesëkatëshe, nga të cilat u vërtetua se ka kaluar në llogari të subjektit shuma totale e qirave në vlerën 1,161,750 lekë.

- Në lidhje me pasurinë nr. ***, kati i dytë i godinës, subjekti në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se: “*Gjatë gjithë periudhës së deklaramit ka në përdorim një pjesë të apartamentit (68.4 m²) dhe që nga viti 2012 e në vijim posedohet nga vetë subjekti*”. Për të dyja kontratat e qirasë që i përkasin kësaj pasurie: njëra në periudhën 1.5.2019 – 1.5.2021 dhe tjetra në periudhën 1.6.2021 – 1.6.2023, u vërtetua përfitimi prej subjektit i qirave nga kjo pasuri. Po kështu, për periudhën 10.11.2014 – 5.2.2016 janë përfitur nga subjekti në total 510,000 lekë kreditime me përshkrimin “*Likuidim qira*”, për të cilat nuk është e qartë se për cilën pasuri bëhet fjalë. Por, nisur nga deklarimi i subjektit se pasuria nr. *** është poseduar prej saj që në vitin 2012, si dhe nga deklarimi se në llogarinë e saj bankare kanë shkuar të ardhurat nga qiraja të kësaj pasurie, duket se e ardhura prej 510,000 lekësh ka qenë për shkak të dhënies me qira të pasurisë nr. *** apartament në posedim të subjektit të rivlerësimit.

- Për pasurinë nr. *** kontrata e energjisë elektrike është lidhur në emër të subjektit në vitin 2006 dhe në vitin 2015 ka kaluar në emër të nënës së saj D. T.

- Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si adresë banimi adresën e pasurisë në pronësi të nënës, por nuk ka deklaruar përdorimin/posedimin e pasurisë, ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit standard e ka deklaruar këtë fakt. Po kështu, në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka dhënë deklarime për të ardhurat nga qiratë apo sqarime në lidhje me faktin se të ardhurat nga qiratë nuk i përkisnin asaj por nënës së saj.

26.7. Në përfundim të hetimit administrativ konstatohet se subjekti, e cila duket se është sjellë si pronare e pasurisë nr. ***, nuk ka deklaruar përdorimin/posedimin e kësaj pasurie në deklaratën

Vetting sipas kërkesave të shtojcës nr. 2 dhe formularit të deklarimit *Vetting* sipas ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet shprehimisht detyrimi i subjekteve për të deklaruar pasuri në përdorim dhe burimin e krijimit të tyre. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë shpjegime e dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

Në analizë të të dhënave të administruara dhe parashtrimeve të subjektit, në përfundim të procesit u konstatua se subjekti nuk e ka kundërshtuar barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, arsyetuar si vijon:

Së pari, sikurse edhe në deklarimet e mëparshme, në parashtrime vërehet se subjekti në mënyrë koncize i referohet faktit që kalimi i qirave të evidentuara në llogarinë e saj bankare ka qenë për shkak se nëna nuk ka pasur llogari bankare dhe se të ardhurat nga qiratë nuk i përkisnin asaj, prandaj edhe nuk i ka deklaruar. Sipas saj, të ardhurat nga qiratë i janë dhënë nënës dhe babait për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë nuk mund ta dokumentojë këtë fakt. Gjithashtu, nuk e ka mohuar faktin që e ardhura prej 510,000 lekësh është nga dhënia me qira e pasurisë nr. ***.

Deklarimet e subjektit nuk mund të vlerësohen të besueshme për sa kohë:

- i) në deklaratën *Vetting* nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me të ardhurat nga qiraja të kaluara në llogari të saj së paku gjatë periudhës 10.11.2014 – 5.2.2016 në shumën 510,000 lekë, të ardhura të cilat sipas shtojcës 2 të kërkesave të ligjit nr. 84/2016 subjekti kishte detyrimin për t'i deklaruar;
- ii) nëna e subjektit ka përfiturar të ardhura në shuma të konsiderueshme nga dhënia me qira e pasurive të tjera pjesë përbërëse e godinës pesëkatëshe me të cilat mund të përballonte shpenzimet e jetesës;
- iii) është e paqartë përse në emër të nënës së subjektit nuk është hapur një llogari bankare ku të depozitoheshin të ardhurat nga qiratë dhe nëpërmjet një prokure të posaçme subjekti të kishte të drejtën e veprimit në këto llogari bankare, për më tepër, në llogari të subjektit kanë shkuar vetëm të ardhura nga dhënia me qira të pasurisë nr. *** dhe jo të ardhura nga pasuri të tjera pjesë përbërëse të godinës pesëkatëshe ku nëna e subjektit ka qenë palë qiradhënëse.

Së dyti, subjekti në parashtrime nuk ka dhënë ndonjë shpjegim në lidhje me konstatimin se për pasurinë nr. *** kontrata e energjisë elektrike është lidhur në emër të subjektit në vitin 2006 dhe në vitin 2015 ka kaluar në emër të nënës së saj D. T.. Dhe në seancë dëgjimore pas pyetjes së saj në lidhje me këtë konstatim nuk dha ndonjë arsye bindëse duke deklaruar se nuk ka pasur dijeni për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratës në emrin e saj duke ia faturuar këto veprime babait të saj. Për më tepër, lidhja e kontratës së energjisë elektrike për këtë pasuri në emër të subjektit është e pajustificueshme, për sa kohë në vitin 2006 kur është lidhur kontrata e energjisë elektrike (po as në periudhën në vijim) subjekti nuk ka qenë pjesë e procedurave të legalizimit/regjistrimit të ndërtesës, si dhe nuk ka lidhur ndonjë akt në emër të saj duke deklaruar në vijimësi se nuk ka pasur asnjë lidhje apo kontribut në këtë pasuri.

Së treti, subjekti nuk ka dhënë parashtrime konkrete në lidhje me konstatimin se është sjellë si pronare e pasurisë nr. ***. Sa i takon konstatimit se nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* posedimin/përdorimin e kësaj pasurie, duket se subjekti i referohet faktit se ka deklaruar adresën e pasurisë si të vetmen adresë ku ka jetuar, e cila, sipas saj, nuk ishte/është në pronësinë e saj dhe as posedohej prej saj. Pavarësisht faktit se subjekti ka deklaruar adresën e pasurisë së godinës pesëkatëshe si adresë banimi në deklaratën *Vetting*, në përfundim të procesit Komisioni vlerëson se:

i) nuk qëndron pretendimi që pasuria nuk posedohej prej saj, pasi nga të dhënat e hetimit administrativ, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në konstatimet në përfundim të këtij hetimi, të paktën që nga viti 2012 pasuria është poseduar prej subjektit, fakt i deklaruar prej saj edhe në përgjigje të pyetësorit standard;

ii) nuk qëndron pretendimi se formulari i deklarimit është i orientuar drejt pasurive të akumuluar, pjesës takuese në këto pasuri, si dhe burimit të krijimit, pasi deklarata e pasurisë *Vetting*, sipas shtojcës 2, është miratuar me ligjin nr. 84/2016, i cili në nenin 31, pika 1, parashikon detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklarimin e pasurive në pronësi, në posedim apo në përdorim, si dhe burimin e tyre.

26.8. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në konsideratë të faktit që pronësia mbi pasurinë nr. *** i përket nënës së subjektit dhe marrëdhëniet prind-fëmijë legjitimojnë lejimin e përdorimit të pasurive nga fëmijët, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se kemi të bëjmë me fshehje të pasurisë nr. *** nga ana e subjektit. Por, deklarimi i pasurisë si adresë banimi nuk e përjashton subjektin nga detyrimi për deklarimin e pasurisë si pasuri në posedim/përdorim në deklaratën *Vetting*, detyrim të cilin subjekti nuk e ka përmbushur. Duke e parë këtë pasaktësi në raport me rrethana të rezultuara nga hetimi si: (i) mungesa e deklarimeve apo sqarimeve në këtë deklaratë në lidhje me të ardhura të qirave kaluar në llogarinë e saj bankare në shumën 510,000 lekë gjatë periudhës 2014 – 2016; (ii) paqartësitë dhe mungesa e të dhënave në lidhje me destinacionin e përdorimit të shumës totale prej 1,161,750 lekësh të përfituar nga dhënia me qira e pasurisë nr. ***; (iii) lënia e pasurisë si garanci hipotekore për marrjen e kredisë me kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.2019 (për të cilën është konstatuar ndryshimi i destinacionit dhe deklarime të rreme të subjektit në formularin e kredisë, trajtuar hollësisht në paragrafin 30 të këtij vendimi), Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *Vetting* ka kryer të paktën fshehje të pasurisë në përdorim, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegji në një rast të ngjashëm⁶.

Në lidhje me disa kredi që subjekti ka marrë dhe si kolateral është vënë godina pesëkatëshe, ndër të tjera edhe pasuria nr. ***

Gjatë hetimit administrativ nga dokumente të vëna në dispozicion nga Fondi Besa⁷ rezultoi se subjekti ka marrë kreditë si vijojnë:

27. Me kontratën e huas nr. ***kol., nr. *** rep., datë 15.1.2009, është marrë kredi me afat 12-mujor, në shumën 300,000 lekë, ku garant kanë dalë shtetasit K. T. dhe D. T., të cilët kanë lënë si garanci/peng elektroshtëpiaket (televizor, lavatriçe, sobë, frigorifer etj.), me vlerë tregu 500,000 lekë. Arsyeja e përdorimit është “për aktivitetin e punësuar”. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Fondi Besa, rezulton se subjekti ka kryer pagesa për shlyerjen e kredisë, duke depozituar në llogarinë bankare të Fondit Besa në BKT për periudhën 6.2.2009 – 8.5.2009 shumën 132,739 lekë dhe pjesën e mbetur e ka mbyllur me kredinë e marrë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2009, në shumën 2,500,000 lekë. Në përfundim të hetimit administrativ, për Komisionin mbetet i paqartë destinacioni i përdorimit të kësaj kredie dhe arsyeja përse është marrë, pasi në kohën e marrjes së kredisë subjekti nuk ka qenë duke e ushtruar aktivitetin privat dhe as e punësuar në sektorin privat.

27.1. Në përfundim të procesit, në lidhje me këtë kredi u konstatua se:

Gjatë parashtrimeve subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me këto paqartësi, por ka ndryshuar destinacionin e kredisë “për aktivitetin e punësuar”, duke deklaruar: “*Këtë kredi, me sa*

⁶ Shihni vendimin nr. 13 (JR), datë 14.4.2024, paragrafët 17.8 - 17.12.

⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, në dosjen e Komisionit.

*kujtoj, e kam marrë për nevoja jetësore të përditshmërisë me miratimin edhe të prindërve të cilët kanë dalë garantorë të kësaj kredie”. Është i pabesueshëm dhe i palogjikshëm pretendimi se të ardhurat e përfituara nga kredia janë përdorur për shpenzime të përditshmërisë jetike, sidomos në kushtet kur në vitin 2009 nëna e subjektit ka dhënë me qira një pjesë të godinës pesëkatëshe, sipas kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.4.2009, sipas së cilës D. T. i ka dhënë me qira znj. M. B. për një afat 5-vjeçar 1.12.2008 – 1.12.2013, për qëllim zyre, kundrejt vlerës 900 euro/muaj.*

28. Me kontratën e huas dhe hipotekore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2009, është marrë kredi në shumën 2,500,000 lekë për aktivitetin “avokati”.

28.1. Në lidhje me këtë kontratë, gjatë hetimit u konstatua se:

- Në formularin e aplikimit, subjekti ka deklaruar se do të marrë kredi biznesi si avokate (ndërkohë që ka qenë juriste në DPA) në shumën 2,500,000 lekë, me qëllim kryerje punimesh dhe blerje pajisjesh për krijimin e një biznesi të ri bar-restorant në objektin e lënë si garanci (duke qenë se punon si avokate dhe si asistent-notere në zyrën e noteres M. D., e cila është edhe noterja e Fondit Besa), biznes që do të krijohet përballë shkollës “****”. Kredia është marrë me afat 57-mujor, ku dorëzanëse ka dalë D. T., duke lënë si garanci hipotekore pronën e regjistruar në emër të saj, pasuria nr. ***, truall me sip. 185 m² dhe sipërfaqe ndërtese 71 m², Tiranë, në rrugën “****”, pronë me një vlerë tregu prej 20,000,000 lekësh, si dhe të gjitha pasuritë që disponojnë e do të krijojnë në të ardhmen.

- BKT-ja⁸ konfirmon llogarinë bankare të znj. Majlinda Tosku – Fondi Besa, ku rezulton se në datën 25.5.2009 nga Fondi Besa është disbursuar për Majlinda Toskun kredi në shumën 2,242,047 lekë. Kjo vlerë është shuma e mbetur pasi është mbajtur fondi i garancisë 3%, si dhe është paguar diferenca nga kredia e mëparshme e datës 16.1.2009 prej 182,953 lekësh. Me disbursimin e kredisë subjekti ka tërhequr *cash* në datën 26.5.2009 shumën 1,000,000 lekë dhe në datën 4.6.2009 shumën 300,000 lekë. Pjesa e mbetur e kredisë është tërhequr nga subjekti pjesë-pjesë deri në fund të vitit me tërheqje më të vogla. Nga veprimet bankare nuk ka të dhëna se si është përdorur kredia.

- Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Fondi Besa, rezulton se subjekti ka kryer pagesa për shlyerjen e kredisë duke depozituar *cash* në llogarinë bankare të Fondit Besa në BKT për periudhën 2.7.2009 – 19.5.2011 shumën 3,414,308 lekë. Kredia e marrë për një afat prej 57 muajsh është mbyllur nga subjekti përpara afatit, duke paguar në datën 19.5.2011 shumën totale prej 1,853,808 lekësh dhe mbyllur përfundimisht kredinë brenda një afati prej 24 muajsh. Për Komisionin ka qenë e paqartë arsyeja se përse subjekti nuk i ka depozituar fillimisht shumën në llogarinë e saj në BKT dhe më pas me transfertë të kryente pagesën e kësteve të kredisë për llogari të Fondit Besa, por i ka depozituar ato *cash* në llogarinë e Fondit Besa pranë BKT-së.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kjo pronë ndër vite ka pasur destinacion bar-kafe dhe është përdorur ndër vite nga vëllezërit e saj ose është dhënë me qira, siç është edhe statusi i saj aktual. Në këto kushte, për Komisionin ka qenë e paqartë dhe e pajustificuar marrja e kredisë nga subjekti dhe jo nga vëllezërit e saj.

- Sa i takon ushtrimin të aktivitetit privat nga subjekti apo nga vëllezërit e saj, nga të dhënat në QKB dhe të dhënat tatimore të administruara (trajtuar hollësisht në paragrafin nr. 32 të këtij vendimi), subjekti ka qenë e regjistruar si person fizik/avokate në vitin 2009, por nuk e ka ushtruar atë, pasi nuk ka paguar detyrimet ligjore dhe nuk ka përfutur të ardhura si avokate. Po kështu, rezulton se vëllai i subjektit A. T. është regjistruar në datën 13.1.2014 si person fizik me objekt veprimtarie bar-kafe në adresën Rruga e ****, pajisur me NIPT ***, të cilin e ka pezulluar në datën

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, në dosjen e Komisionit.

14.12.2017, ndërsa vijon të jetë ende aktiv NIPTI *** në emër të personit fizik “****”, me objekt veprimtarie bar-kafe, me adresë në Rrugën e ***, i regjistruar më 14.12.2017. Siç vërehet, asnjë prej vëllezërve të subjektit nuk ka ushtruar veprimtari bar-kafe gjatë vitit 2009, kur subjekti ka marrë kredinë objekt verifikimi me qëllim investimin për biznes bar-kafe.

- Nga përgjigjja e dhënë me *email* të datës 9.1.2024 në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar në mënyrë të ndryshme me deklaratimet e mëparshme për këtë pyetësor se, as ajo vetë dhe asnjë nga familjarët e saj nuk kanë hapur biznes të llojit bar-restorant. Sipas subjektit, i vetmi aktivitet tregtar i regjistruar në QKB ka qenë personi fizik “Majlinda Tosku”, me NIPTI ***, por edhe ky pa ofruar asnjë lloj shërbimi sipas objektit të aktivitetit. Po kështu, subjekti deklaroi një destinacion të ri të përdorimit të kredisë: *“Qëllimi i marrjes së kredisë është për kryerjen e një investimi për ambient zyre dhe mobilimin e saj në shumën 2,500,000 lekë. Në datën 2.2.2009 ajo ka lidhur marrëdhëniet e punës me DPA-në, mirëpo duke qenë në periudhë prove 3 muajt e parë, në kushtet e pasigurisë së vijimit të marrëdhënies së punës ajo ka lidhur kontratën e kredisë me nr. *** kol., nr. *** rep., datë 30.4.2009, me Fondin Besa. Kjo kredi është mbyllur në datën 19.5.2011, pasi megjithëse është marrë për një periudhë të gjatë kohore duke qenë se nuk është përdorur për destinacionin e saj, e ka mbyllur brenda një afati 2-vjeçar, pasi nuk e ka përdorur. Burimi i shlyerjes së kësaj kredie është vetë shumën e marrë, si dhe kursimet nga paga”*. Siç vërehet, subjekti deklaroi se qëllimi i marrjes së kredisë është vetëm investimi për ambient zyre (investim të cilin nuk rezultoi ta ketë kryer), ndërkohë që në formularin e aplikimit për kredi ka deklaruar marrjen e kredisë “me qëllim kryerje punimesh dhe blerje pajisjesh për krijimin e një biznesi të ri bar-restorant përballë shkollës “****” që është edhe adresa e godinës pesëkatëshe.

- Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me kredinë objekt verifikimi, u konstatua se subjekti nuk e ka ushtruar aktivitetin si avokate, sikurse ka deklaruar në formularin për marrjen e kredisë, pasi nuk ka shlyer detyrimet ligjore (madje figuron me gjobë në organet tatimore) dhe nuk ka prodhuar të ardhura (fakt i pranuar edhe nga ajo vetë në përgjigje të pyetësorit nr. 2). Po kështu, nuk rezultoi të kenë ushtruar aktivitetin biznesi bar-restorant për periudhën 2009 – 2013 (as ajo e as familjarët e saj), si dhe as të ketë kryer investime për mobilim zyre avokatie. Për më tepër, është e paqartë përse subjekti nuk e ka shlyer kredinë menjëherë për shkak se nuk u përdor sipas destinacionit, po e ka shlyer dy vite më vonë me të ardhurat e përfituara prej kredisë dhe kursimet nga paga.

28.2. Në parashtrimet e veta subjekti deklaroi në mënyrë koncize se fillimisht, pasi kishte filluar punë në DPA ku ishte në kohë prove për tre muaj, për shkak të pasigurisë mendoi të merrte një kredi për të hapur një zyrë avokatie. Më tej sqaroi se duke qenë se marrëdhëniet e punës në DPA vijoi pas datës 2.5.2009, së bashku me vëllezërit menduan që këtë kredi ta përdornin me qëllim kryerje punimesh dhe blerje pajisjesh për krijimin e një biznesi të ri bar-restorant në objektin e lënë si garanci biznes që do të krijohej përballë shkollës “****”. Duke qenë se edhe ky plan nuk u realizua dhe paratë nuk janë vënë në punë, këto para u bënë burimi i vetëm i shlyerjes së detyrimit pranë Fondit Besa në datën 19.5.2011. Sa i takon faktin përse nuk e ka shlyer kredinë menjëherë pasi nuk u përdor sipas destinacionit, por e ka shlyer dy vite më vonë dhe përpara afatit të parashikuar, subjekti ka deklaruar se në atë periudhë ajo vazhdimisht ka menduar dhe dëshiruar të ketë një aktivitet privat për ta zhvilluar (ndoshta një ëndërr rinore që nuk gjeti terrenin e duhur).

28.3. Në përfundim të procesit në lidhje me kredinë objekt verifikimi u konstatua se:

a. Deklarimet e subjektit gjatë procesit dhe në parashtrime sipas të cilave fillimisht kredia u mor për të hapur një zyrë avokatie, bie në kundërshtim me deklaratimet në formularin e aplikimit, ku përcaktohet shprehimisht se kredia do të merrej me qëllim kryerje punimesh dhe blerje pajisjesh

për krijimin e një biznesi të ri bar-restorant në objektin e lënë si garanci, aktivitet i cili nuk rezulton të jetë ushtruar as nga subjekti dhe as nga familjarët e saj.

b. Objekti i kredisë “për aktivitetin avokate” dhe deklarimi në formularin e kredisë se subjekti punon si avokate dhe si asistente notere në zyrën e noteres M. D., e cila është edhe noterja e Fondit Besa, bie në kundërshtim me realitetin, pasi subjekti realisht nuk e ka ushtruar asnjëherë aktivitetin si avokate dhe në kohën e marrjes së kredisë ka qenë e punësuar pranë DPA-së. Po kështu, është vërtetuar se subjekti nuk ka qenë asistente notere e noteres M. D. (trajtuar në paragrafin 32.1 të këtij vendimi), konstatim për të cilin subjekti (në mënyrë të përsëritur) nuk ka dhënë asnjë deklaram në parashtrimet e veta.

c. Deklarimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguara në datën 5.12.2023, se kjo pronë ndër vite ka pasur destinacion bar-kafe, bien në kundërshtim me deklaramet e bëra në përgjigjet e dërguara me *email* të datës 9.1.2024, ku ka deklaruar se as ajo vetë dhe asnjë nga familjarët e saj nuk kanë hapur biznes të llojit bar-restorant.

ç. Deklarimi i subjektit se shlyerja e kredisë është bërë përpara afatit me paratë e përfituara prej kredisë (pas dy vitesh) pasi nuk u përmbush destinacioni, është i pabesueshëm për sa kohë është vërtetuar që kredia është tërhequr pjesë - pjesë prej subjektit dhe në kushtet kur shlyerja e kredisë nuk është bërë në mënyrë të menjëhershme por pjesë - pjesë dhe *cash* në llogarinë bankare të Fondit Besa në BKT për periudhën 2.7.2009 – 19.5.2011. Për më tepër, në datën 10.5.2011, pra pasi ka shlyer tërësisht kredinë objekt verifikimi, subjekti ka marrë edhe një kredi tjetër pranë Credins Bank në shumën 4,500,000 lekë, destinacioni i së cilës mbeti i pavërtetuar (trajtuar në paragrafin 36 e vijues të këtij vendimi). Pra, (në mënyrë të përsëritur) mbetet i pavërtetuar destinacioni i përdorimit të kredisë, për të cilën (po në mënyrë të përsëritur) subjekti ka deklaruar se e ka shlyer me të ardhura të përfituara nga kredia e marrë (në çdo rast kreditë janë shlyer me pagesa *cash*).

29. Me kontratën e huas dhe hipotekore nr. ***rep., nr. *** kol., datë 9.4.2013, është marrë kredi në shumën 3,000,000 lekë, me afat 84 muaj, me qëllim financimin e investimeve për biznes dhe nuk mund të përdoret për tjetër qëllim, ku dorëzanës kanë dalë shtetasit D. T., G. T. (vëllai i subjektit) dhe M. P. Garanci për këtë kredi është lënë pasuria e llojit apartament, me sip. 138.4 m², nr. pasurie ***, rruga “***”, e vlerësuar me një vlerë tregu prej 7,000,000 lekësh.

29.1. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

- Nuk ka të dhëna për ushtrimin e ndonjë aktiviteti biznesi nga subjekti apo familjarë të saj. Si avokate ajo nuk e ka ushtruar aktivitetin, pavarësisht se ka qenë e regjistruar.

- BKT-ja⁹ konfirmon se në llogarinë bankare të subjektit me emërtimin Majlinda Tosku - Fondi Besa, në datën 12.4.2013 është disbursuar kredia në shumën 2,880,000 lekë. Subjekti e ka tërhequr këtë kredi në këtë mënyrë: në datën 12.4.2013 ka tërhequr *cash* 1,000,000 lekë; në datën 16.4.2013 ka tërhequr *cash* 500,000 lekë; në datën 13.5.2013 ka tërhequr *cash* 184,000 lekë; dhe në datën 14.5.2013 ka tërhequr *cash* pjesën e mbetur prej 1,196,000 lekësh. Nga veprimet bankare nuk ka të dhëna se si është përdorur kredia.

- Subjekti ka kryer pagesa për shlyerjen e kredisë për periudhën 13.5.2013 – 13.2.2015 në shumën 4,321,100 lekë. Në pjesën më të madhe pagesat janë kryer duke depozituar *cash* në llogarinë bankare të Fondit Besa në BKT, por ka edhe pagesa *cash* në arkën e Fondit Besa. Kredia e marrë për një afat prej 84 muajsh është mbyllur nga subjekti për 21 muaj, duke paguar në arkën e Fondit Besa në datën 13.2.2015 shumën totale prej 2,450,000 lekësh.

⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2022, në dosjen e Komisionit.

- Në lidhje me këtë kredi, në përgjigjen e dërguar me *email* të datës 9.1.2024 subjekti ka deklaruar se nga ana e familjes së saj përgjatë periudhës 2009 – 2013 është vijuar të investohej në pasurinë e paluajtshme, pronë e familjes, dhe për këtë nevojiteshin burime të tjera financiare. Në kushtet kur objekti nuk ishte përfunduar ende, për të ndihmuar familjen e saj, si dhe për shkak të historikut me Fondin Besa është lidhur kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.4.2013, me qëllim financimin e investimeve dhe ka sqaruar se likuidimi i kësaj kredie është shlyer nga familjarët e saj. Një pjesë e detyrimit është likuiduar nga të ardhurat e qirave që vëllezërit dhe nëna e saj kanë siguruar. Ajo deklaroi se vëllezërit e saj, në dijeninë e saj, kanë hapur biznes bar-kafe dhe kanë ushtruar aktivitet tregtar, por nuk ka informacion për sa i takon kohëzgjatjes dhe xhiros së realizuar, pasi marrëdhënia me vëllezërit ka qenë vetëm në kuadër të marrëdhënies familjare, por jo e lidhur me aktivitetin tregtar.

- Nuk qëndron pretendimi i subjektit se në vitin 2013 objekti nuk kishte përfunduar pasi në vitin 2011 është marrë leja e legalizimit për objekt pesëkatësh. Nga ana tjetër, subjekti ka deklaruar se godina ***-katëshe është ndërtuar me kontributin e vëllezërve të saj, pa e përmendur kredinë objekt verifikimi si burim. Po kështu, subjekti ka ndryshuar destinacionin e përdorimit të kredisë. Është i paqartë deklarimi se likuidimi i kësaj kredie është kryer nga familjarët e saj, ndërkohë që të gjitha pagesat për shlyerjen e saj janë bërë *cash* nga vetë subjekti, sikurse vërtetojnë veprimet bankare të kryera.

29.2. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me kredinë objekt verifikimi, u konstatua se subjekti nuk e ka ushtruar ndonjëherë aktivitetin si avokate dhe as ndonjë aktivitet tjetër biznesi. Subjekti është kontradiktore në deklaratimet e dhëna gjatë hetimit në lidhje me destinacionin e kredisë, pasi deklaroi se është marrë me qëllim investime në ndërtimin e objektit, ndërkohë që sipas kontratës së kredisë qëllimi është “financimi i investimeve për biznes”. Mbetet i paqartë destinacioni i përdorimit të kredisë. Është e paqartë gjithashtu arsyeja e marrjes dhe shlyerjes së saj nga subjekti shumë më shpejt nga afati i parashikuar në kontratë, ndërkohë që sipas saj ajo nuk kishte asnjë interes.

29.3. Në parashtrimet e veta subjekti ka dhënë të njëjtat deklaratime, si edhe gjatë hetimit administrativ dhe nuk ka dhënë asnjë deklaratim në lidhje me faktin se ajo nuk ka ushtruar ndonjë aktivitet biznesi. Subjekti vijon t’i qëndrojë deklaratimit se kredia objekt vlerësimi është marrë me qëllim përfundimin e investimeve në objektin pesëkatësh, në të cilin është investuar përgjatë periudhës 2009 – 2013. Subjekti lë të kuptohet se me investim në objekt nënkupton rregullimin dhe përshtatjen për bar-kafe që ka kërkuar investim më vete, por nuk ka paraqitur asnjë provë që të vërtetojë që godina është përdorur për ushtrimin e ndonjë aktiviteti biznesi bar-kafe.

Subjekti pranon faktin se është ndryshuar destinacioni i kredisë, duke deklaruar në mënyrë të pakuptueshme se: “*Ky fakt nuk mund të prevalojë mbi nevojën time familjare dhe njerëzore. Mbi të gjitha ky veprim i imi nuk ka cenuar interesa apo të ketë sjellë dëme*”. Po kështu, subjekti deklaroi se vëllezërit kanë hapur biznes bar-kafe dhe kanë ushtruar aktivitet tregtar, por nuk ka paraqitur asnjë provë për ta vërtetuar këtë fakt. Sa i takon shlyerjes së kredisë sqaroi se: “*Për sa kohë kredia ishte në emrin tim, edhe shlyerjen e kësaj kredie do e bëja po unë nga ana formale duke përdorur të ardhurat e vëllezërve*”.

29.4. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes në lidhje me këtë kredi u konstatua se:

a. Subjekti ka ndryshuar (në mënyrë të përsëritur) destinacionin e kredisë, nga kredi me qëllim financimin e investimeve për biznes në kredi të marrë me qëllim investime në godinën pesëkatëshe.

Për më tepër, në kontratën e kredisë është përcaktuar se kredia nuk mund të përdoret për tjetër qëllim.

b. Subjekti është kontradiktor me deklaratimet e mëparshme në lidhje me periudhën e ndërtimit të objektit. Po kështu, deklarimi në përgjigjen e dërguar me *email* të datës 9.1.2024 se kredia ka shërbyer si burim për investime në objektin pesëkatësh bie në kundërshtim me deklaratimet e bëra në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ku i është kërkuar specifikisht të deklarojë me çfarë kontributi financiar është investuar godina ***-katëshe, ku subjekti nuk e ka deklaruar kredinë objekt verifikimi si burim duke deklaruar se objekti është ndërtuar nga vëllezërit e saj.

c. Është e pajustificueshme marrja e kredisë nga subjekti dhe jo nga vëllezërit e saj, të cilët kanë qenë kontribuues në ndërtimin e godinës pesëkatëshe apo pretendentë për të ushtruar një aktivitet biznesi e, për më tepër, në kushtet kur sipas subjektit kredia është shlyer me të ardhura të tyre.

ç. Subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore pasi në përgjigjen e dhënë me *email* të datës 9.1.2024 (vazhdim i përgjigjeve të pyetësorit nr. 2) ka deklaruar se as ajo vetë dhe asnjë nga familjarët e saj nuk kanë hapur biznes të llojit bar-restorant, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se pasuria nr. *** (pjesë përbërëse e godinës pesëkatëshe) ndër vite është përdorur për biznes bar-kafe. Edhe në parashtrime subjekti ka deklaruar se vëllezërit e saj kanë ushtruar këtë biznes, por nuk ka paraqitur asnjë provë për ta vërtetuar këtë fakt.

d. Deklarimi i subjektit në parashtrime se nuk ka informacion për sa i takon kohëzgjatjes dhe xhiros së realizuar nga aktiviteti i biznesit bar-kafe pasi marrëdhënia me vëllezërit është vetëm në kuadër të marrëdhënies familjare, por jo e lidhur mbi aktivitetin tregtar, është i pabesueshëm në kushtet kur subjekti ka marrë disa kredi pikërisht në funksion të aktivitetit të biznesit të ushtruar nga vëllezërit. Ky deklarim i subjektit në parashtrime vlerësohet se është bërë për të justifikuar mungesën e të dhënave për ushtrimin e një aktiviteti biznesi nga vëllezërit e saj.

dh. Mbetet i pavërtetuar destinacioni i kredisë.

e. Subjekti në parashtrime ka deklaruar se shlyerja e kësaj kredie do të bëhet nga ana formale prej saj, por, duke përdorur të ardhurat e vëllezërve, po nuk ka paraqitur asnjë dokument që vërteton punësimin apo të ardhura të ligjshme të vëllezërve si në Shqipëri ashtu edhe në Itali, duke lënë të paqartë me çfarë të ardhurash është shlyer kredia nëpërmjet likuidimeve *cash*. Gjithashtu, si nga të dhënat bankare ashtu edhe të dhëna të institucioneve financiare që bëjnë dërgesa nga jashtë vendit (Western Union, MoneyGram etj.) nuk ka informacione për dërgesa nga vëllezërit për cilëndo periudhë.

30. Me kontratën e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.2019, është marrë kredi me afat 120 muaj, në shumën 50,000 euro, me qëllim për investime. Si garanci hipotekore për këtë kredi është vendosur apartamenti i regjistruar në regj. hipotekor nr. pasurie *** (pasuri e përdorur nga subjekti), në pronësi të shtetasës D. T., e cila është njëkohësisht edhe dorëzënëse për këtë kredi.

30.1. Në lidhje me këtë kredi gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

- Referuar relacionit të datës 4.9.2019, përpiluar nga oficeri i kredisë A. Ç. për kredinë e biznesit të marrë pranë Fondit Besa nga M. T. si person fizik prej 50.000 euro, oficeri argumenton se arsyeja e dhënë nga M. T. për marrjen e kësaj kredie është sepse 3 ambientet në katet e sipërme të pronës së lënë si garanci kërkon t'i arrijë për hoteleri, duke qenë se kërkesat e tregut, por edhe pozicioni i godinës është mjaft i favorshëm. Oficeri është shprehur se M. T. nuk gëzon licencë për ushtrimin e këtij aktiviteti (hotelieri), mirëpo do të pajiset më pas, ndaj kërkon që të bëhet një përjashtim për këtë rast duke u bazuar në historikun e mirë të mëparshëm që kjo kliente ka me institucionin e tyre. Gjithashtu, në këtë relacion oficeri A. Ç. shprehet se: "*Klientja ka të ardhura*

*shtesë nga qiradhënia e ambientit të katit të parë, e cila është bar-kafe “***” dhe nga kjo përfiton 40,000 lekë në muaj”.*

- Në formularin e aplikimit për kredi biznesi të plotësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në datën 28.8.2019, si edhe vetë deklarimi për biznes i po të njëjtës datë të dhënë nga Majlinda Tosku, në të cilin ajo deklaroi se ushtron aktivitetin në fushën e hotelerisë në adresën Rruga e ***, me status aktiv dhe se ka të ardhura mujore dhe fitim neto nga ky biznes në shumën 1,800 euro/muaj. Gjithashtu ajo deklaroi se është e vetëpunësuar në biznesin e saj familjar. Gjithashtu ka të ardhura shtesë në vlerën 600 euro. Nga të dhënat e QKB-së nuk rezultoi që subjekti apo familjarët e saj të kenë ushtruar apo të ushtrojnë aktivitetet në fushën e hotelerisë.

- Në përgjigjen e dhënë në pyetësonin nr. 2, subjekti ka ndryshuar destinacionin e kësaj kredie duke deklaruar se kjo kredi ka shkuar për të blerë¹⁰ apartamentin në katin e 4-t të godinës pesëkatëshe nga vëllai i saj G. T.

- Në lidhje me pasurinë e blerë nga vëllai G. T., pas verifikimeve u konstatua se subjekti ka blerë nga ky shtetas pasurinë nr. ***, apartamentin me sip. 138.4 m² dhe se për blerjen e pasurisë është përdorur kredia objekt shqyrtimi në vlerën 50,000 euro.

- Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me kredinë objekt verifikimi, u konstatua se subjekti dhe familjarët e saj nuk kanë ushtruar aktivitetet në fushën e hotelerisë dhe se subjekti nuk ka qenë asnjëherë e punësuar në biznes familjar. Ka mospërputhje të deklarimeve në formularin e kredisë në lidhje me qëllimin e marrjes së kredisë (ushtrimin e një aktiviteti në fushën e biznesit/hoteleri) ku, ndër të tjera, ajo ka deklaruar *se ushtron aktivitetin në fushën e hotelerisë në adresën Rruga e *** me status aktiv dhe se ka të ardhura mujore dhe fitim neto nga ky biznes në shumën 1,800 euro/muaj dhe se është e vetëpunësuar në biznesin e saj familjar*, me deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësonit nr. 3, ku ka deklaruar *se ajo dhe familjarët e saj nuk kanë ushtruar aktivitetet në fushën e hotelerisë dhe nuk ka qenë asnjëherë e punësuar në biznes familjar dhe se kredia prej 50,000 euro është përdorur për blerjen e apartamentit nga vëllai i saj G. T. në katin e ***-t të godinës pesëkatëshe, fakt i cili rezultoi të jetë i vërtetë.*

30.2. Në parashtrimet e veta subjekti i referohet vetëm faktit që kredia është përdorur për blerjen e pasurisë nga vëllai G. T., pa dhënë asnjë deklaram në lidhje me konstatimet e Komisionit.

30.3. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes në lidhje me këtë kredi konstatohet se:

a. Subjekti në mënyrë të përsëritur ka ndryshuar destinacionin e përdorimit të kredisë.

b. Subjekti ka kryer deklaram të rremë në formularin e kredisë në lidhje me: (i) ushtrimin e një aktiviteti në fushën e hotelerisë me status aktiv; (ii) përfitimin e të ardhurave mujore dhe fitimit neto nga ky biznes në shumën 1,800 euro/muaj; (iii) faktin se është e vetëpunësuar në biznesin e saj familjar dhe ka të ardhura shtesë në vlerën 600 euro.

31. Subjekti ka marrë një super kredi pranë BKT-së, me kontratën e kredisë datë 26.12.2017, paraqitur në pyetësonin standard dhe administruar edhe nga ILDKPKI-ja, në vlerën 500,000 lekë, me qëllim për rregullim dhe mobilim shtëpie, pa vënë si garanci ndonjë pasuri dhe pa ndonjë dorëzanës, kredi e cila është shlyer nga subjekti në vitin 2021.

31.1. Gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë kredi ka rezultuar se në formularin e aplikimit subjekti ka deklaruar se vila nr. ***, ndodhur në adresën rruga “****” dhe Rruga e *** në Tiranë është në pronësi të saj për një periudhë mbi 10 vite. Në përfundim të hetimit administrativ mbetej i paqartë destinacioni i përdorimit të kredisë, e cila është shlyer nga subjekti, si dhe deklaratimet e

¹⁰ Shihni kontratën e shitblerjes në shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.12.2023, të dërguar nga ASHK-ja në dosjen e Komisionit.

subjektit në formular bien në kundërshtim me realitetin, pasi subjekti nuk ka qenë ndonjëherë pronare e godinës pesëkatëshe (ajo është bërë pronare e apartamentit në katin e katërt në vitin 2022). Në parashtrimet e veta, subjekti ka deklaruar shkurtimisht se kjo ka qenë një kredi e thjeshtë konsumatore me qëllim për rregullim dhe mobilimin e shtëpisë, pa u referuar se për cilën shtëpi bëhet fjalë, si dhe ka paraqitur dy fatura tatimore shitjeje, përkatësisht në vlerat 122,038 lekë dhe 76,712 lekë, ku nuk lexohen qartë zërat e produkteve/shërbimet e kryera.

31.2. Në përfundim të procesit në lidhje me këtë kredi, vlerësohet se:

Subjekti ka kryer deklaram të rremë në formularin e kredisë, pasi ka deklaruar në mënyrë të pavërtetë se godina e ndodhur në adresën rruga “***” dhe Rruga e ***, në Tiranë, është në pronësi të saj për një periudhë mbi 10 vite, konstatim për të cilin subjekti nuk ka dhënë asnjë deklaram në parashtrime. Po kështu, mbetet i paqartë se për rregullimin/mobilimin e cilës shtëpi është përdorur kredia dhe përse është marrë nga subjekti i rivlerësimit, e cila nuk ka qenë pronare e asnjë prej apartamenteve pjesë përbërëse e godinës pesëkatëshe.

32. Nga ana e Komisionit, referuar faktit që objekti i kredive, si dhe deklaramet e subjektit në formularët për marrjen e tyre i referohen aktivitetit privat të ushtruar nga subjekti apo familjarë të saj, u kryen disa verifikime, nga të cilat rezultoi se:

32.1. Për subjektin Majlinda Tosku:

i) Në datën 16.7.2005 ka marrë licencën e avokatit me nr. ***.

ii) Me shkresat nr. *** prot., datë 3.8.2017 dhe datë 28.8.2017, administruar nga ILDKPKI-ja, DPT-ja dhe DRT Tiranë, konfirmohet se Majlinda Tosku është regjistruar me NIPT *** si person fizik pranë QKB-së, me aktivitetet me fushë veprimtarie “Avokati” nga data 8.1.2009 dhe se është çregjistruar në datën 15.9.2020. Subjekti, personi fizik “Majlinda Tosku”, nuk ka kryer asnjë deklaram për kontribute shoqërore, kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatim i thjeshtuar mbi fitimin. Ky subjekt ka kaluar në status “pasiv” që nga data 29.12.2014, si dhe ka gjoba në sistemin informatik në shumën 10,000 lekë dhe 60 deklarata të padorëzuara.

iii) Me shkresën nr. 2775/1 prot., datë 10.2.2022, QKB-ja me kërkesë të Komisionit ka vërtetuar se Majlinda Tosku ka qenë e regjistruar në datën 8.1.2009 si person fizik, pajisur me NIPT K91308003C dhe e ka çregjistruar si aktivitet në datën 15.9.2020.

iv) Nga të dhënat bankare rezulton se subjekti ka kryer deklaramet në lidhje me punësimin si asistente notere pranë noteres M. D. dhe ka paraqitur vërtetimin lëshuar nga noterja M. D., sipas të cilit subjekti ka qenë e punësuar pranë zyrës së saj në pozicionin asistente notere, me pagë mujore 80,000 lekë, që nga data 19.8.2008. Me kërkesë të Komisionit noterja M. D. ka deklaruar: *“Me sa mbaj mend, për shkak të kohës shumë të gjatë, shtetasja Majlinda Tosku më ka kërkuar të punësohej në zyrën time noteriale me kohë të pjesshme. Jemi dakordësuar për këtë marrëdhënie dhe për kushtet e punës dhe është paraqitur dhe ka punuar pak ditë në zyrën time noteriale, datën e saktë nuk e mbaj mend. Me qëllim lidhjen e kontratës së punës, deklaramin në tatime dhe sigurime shoqërore, si dhe krijimin e dosjes personale si punonjëse i kam kërkuar dokumentacionin përkatës. Majlinda Tosku nuk ma vuri në dispozicion dhe më njoftoi se do vazhonte të punonte në shtet dhe nuk erdhi më në zyrën time të punonte. Në këto kushte Majlinda Tosku nuk ka punuar dhe nuk ka qenë e regjistruar në organe tatimore dhe sigurime shoqërore pranë zyrës sime noteriale”.*

32.2. Sa i takon prindërve, ata nuk figurojnë të regjistruar asnjëherë si persona fizikë apo juridikë.

32.3. Sa i takon vëllezërve të subjektit, rezultoi se:

- Gentian Tosku figuron të jetë i regjistruar në QKB si person fizik në datën 14.12.2017, pajisur me NIPT ***, me objekt veprimtarie “bar-kafe”, me status aktiv.

- A. T.: (i) është regjistruar në QKB si person fizik me objekt veprimtarie “bar-kafe”, në datën 13.1.2014 dhe në datën 14.12.2017 e ka pezulluar aktivitetin me NIPT ***; (ii) sipas vendimit për regjistrim si person juridik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. ***, datë 8.6.2007, ka themeluar shoqërinë “***” sh.p.k., me adresë në ish-serrat ***, ***, km. 1, Tiranë, por nuk ka një regjistrim të këtij vendimi në organet tatimore; (iii) në ekstraktin historik të QKB-së shoqëria “***” sh.p.k., me ortak të vetëm dhe administrator A. T., është pajisur me NIPT ***, regjistruar në QKB në datën 3.4.2008, me adresë Tiranë, ***, autostrada Tiranë – Durrës, km. ***, qendra tregtare “***”, me objekt veprimtarie “Tregti me shumicë dhe pakicë e artikujve të ndryshëm” dhe është me status aktual “Shoqëri në likuidim e sipër”. Ortaku i vetëm dhe administratori i shoqërisë A. T. e ka shpallur shoqërinë në likuidim e sipër që nga data 31.8.2011. Nuk ka bilance të depozituara në QKB dhe subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë të ardhura për periudha të ushtrimit të aktivitetit.

32.4 Bazuar në sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se:

- Subjekti Majlinda Tosku ka qenë e regjistruar si person fizik me ushtrim veprimtarie si avokate, për një periudhë 11-vjeçare, gjatë së cilës nuk vërtetohet të ketë përfituar të ardhura, si dhe nuk ka paguar asnjë detyrim ligjor, përkundrazi figuron debitore në organet tatimore.

- Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, për faktin se që nga momenti që ka filluar punë si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në vitin 2016 e në vijim, ajo ka vijuar të jetë e regjistruar në organet tatimore si avokate, pa bërë pezullim/mbyllje të NIPT-it.

- Subjekti nuk ka qenë asistente notere e noteres M. D., sikurse ka deklaruar në procedurat e marrjes së një kredie.

- Prindërit nuk figurojnë të regjistruar asnjëherë si persona fizikë apo juridikë.

- Vëllai G. T. figuron të jetë i regjistruar në QKB si person fizik në datën 14.12.2017, pajisur me NIPT ***, me objekt veprimtarie “bar-kafe”, me status aktiv.

- Vëllai A. T. figuron të jetë i regjistruar në QKB si person fizik në datën 13.1.2014, me NIPT ***, me objekt veprimtarie “bar-kafe”, të cilin e ka pezulluar në datën 14.12.2017.

Siç vërehet, as subjekti dhe as vëllezërit e saj nuk kanë ushtruar aktivitete privat, përkatësisht në fushën e avokatisë dhe biznesit “bar-kafe” në periudhat e marrjes së kredive të trajtuara më sipër.

33. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me kreditë e marra nga subjekti dhe aktivitetin e ushtruar prej saj, duket se:

- Sa i takon kredive: (i) subjekti në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për investime në aktivitete private të cilat nuk rezultojnë të jenë ushtruar prej saj apo familjarëve të saj; (ii) deklaratimet e subjektit në formularët e marrjes së kredive bien në kundërshtim me deklaratimet e kryera gjatë hetimit administrativ dhe faktet dhe rrethanat e vërtetuara gjatë këtij hetimi; (iii) nuk vërtetohet destinacioni dhe përdorimi i shumave të përfituara nga kreditë e tërhequra nga subjekti i rivlerësimit; (iv) nuk vërtetohen deklaratimet e subjektit se shlyerja e kredive prej saj (në disa raste përpara afatit të parashikuar në kontratë) është me të ardhura të vëllezërve të saj.

- Në lidhje me ushtrimin e aktivitetit privat gjatë periudhës që ka qenë ndihmëse ligjore që nga viti 2016 e në vijim, subjekti ka qenë e regjistruar si person fizik avokate, në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve

publike”, veprimtari që pavarësisht se nuk e ka ushtruar e ka përdorur si mjet për marrjen e kredive të biznesit në mënyrë të përsëritur.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

34. Subjekti nuk ka dhënë asnjë parashtrim lidhur me konstatimet përfundimtare sa i përket kredive të marra e të shlyera prej saj, por ka dhënë sqarime në lidhje me secilën prej kredive, sikundër janë shprehur më sipër në këtë vendim. Vlen të theksohet se gjatë parashtrimeve në lidhje me kredinë e marrë me kontratën e huas dhe hipotekore nr. *** kol., nr. *** rep., datë 30.4.2009, subjekti në përpjekje për të justifikuar dhënien e kredisë nga ana e Fondit Besa, ka deklaruar se ka vepruar në përputhje të plotë me nenet 419 e vijues të Kodit Civil si dhe ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, duke iu referuar nenit 124 “Mbrojtja e klientit” e cituar shprehimisht këtë nen. Po kështu, subjekti deklaroi se *referuar teorisë juridike të detyrimeve, Kontratat e Kredisë, mbështeten në tërësinë e akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet juridike të detyrimeve. Si të tilla kanë burim kryesor Kushtetutën, e cila sanksionon shfaqjen e lirë të vullnetit në lidhjen e një kontrate. E, po kështu, palët kontraktore janë të lira në ushtrimin e kësaj të drejte, sa kohë kjo (kontrata) nuk bie ndesh me parimet e përgjithshme dhe interesat e palëve.*

34.1. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, trajtuar hollësisht në paragrafët më sipër, në përfundim të procesit konstatohet se:

a. Subjekti nuk ka kundërshtuar të kundërtën e konstatimeve se: (i) subjekti në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për investime në aktivitete private të cilat nuk rezultojnë të jenë ushtruar prej saj apo familjarëve të saj; (ii) deklaratimet e subjektit në formularët e marrjes së kredive bien në kundërshtim me deklaratimet e kryera gjatë hetimit administrativ dhe faktet e rrethanat e vërtetuara gjatë këtij hetimi; (iii) nuk vërtetohet destinacioni dhe përdorimi i shumave të përfituara nga kreditë e tërhequra nga subjekti i rivlerësimit; (iv) nuk vërtetohen deklaratimet e subjektit se shlyerja e kredive prej saj (në disa raste përpara afatit të parashikuar në kontratë) është me të ardhura të vëllezërve të saj.

b. Deklarimet e subjektit në parashtrime në përpjekje për të justifikuar ligjshmërinë e dhënies së kredisë së marrë me kontratën nr. *** kol., nr. *** rep., datë 30.4.2009 (trajtuar më sipër), duke iu referuar dispozitave të Kodit Civil apo ligjit “Për bankat nr. 9662/18/12/2006”, janë të pabazuara përderisa është vërtetuar që kredia që subjekti i referohet është dhënë për aktivitetin si avokate dhe me destinacion investime në biznes “bar-kafe”, ndërkohë që as subjekti dhe as vëllezërit e saj nuk kanë ushtruar aktivitet biznesi të çdolloji. Po kështu, edhe në rastet e tjera është vërtetuar se janë dhënë kredi biznesi bazuar në ushtrimin e aktivitetit privat të subjektit të rivlerësimit si avokate, aktivitetit të biznesit “bar-kafe” të vëllezërve të saj, si dhe në një rast në aktivitetin hotelieri, ndërkohë që as subjekti dhe as vëllezërit e saj nuk kanë ushtruar një aktivitet të tillë në kohën e marrjes së kredive. Po kështu, u vërtetua që në aktet e përpiluara nga nëpunësit e kredisë dhe në formularët e deklaratimit të subjektit pasqyrohen fakte dhe rrethana që janë të pavërteta.

35. Në lidhje me aktivitetin privat gjatë periudhës që ka qenë ndihmëse ligjore, në parashtrimet e veta subjekti kundërshtoi qenien në kushtet e konfliktit të interesit dhe duke iu referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, sjell në vëmendje se, referuar nenit 1 të këtij ligji, i cili përcakton edhe qëllimin e ligjit “*Garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë të një zyrtari në ushtrimin e funksioneve*

të veta”, detyra e saj si ndihmëse ligjore nuk ka lidhje me vendimmarrjen. Po kështu, në përpjekje për të argumentuar *mangësinë e procesit në kuadër të hetimit të paplotë, të cekët e të pamjaftueshëm*, deklaroi se nga ana e Komisionit është pranuar se fakti që qenia e regjistruar si subjekt privat nuk ka pasur asnjë pasojë juridike dhe as financiare.

Në vijim, subjekti duke iu referuar nenit 14 të ligjit “Për avokatinë”, deklaroi se nuk është anëtare e Dhomës së Avokatisë në Republikën e Shqipërisë, nuk aderon dhe nuk paguan kuotizacionin e përvitshëm pranë ndonjë Dhome e, rrjedhimisht, e ka të ndaluar të ushtrojë profesionin e avokatit në çfarëdolloj mënyre. Subjekti deklaroi shprehimisht *nëse do të ishte marrë informacion nga ana juaj pranë Dhomës së Avokatisë, do të rezultonte se nuk jam pajisur asnjëherë me leje vjetore për ushtrimin e profesionit si “avokate”*, por nuk rezultoi që të ketë paraqitur ndonjë dokument që të vërtetojë këtë fakt.

Po kështu, subjekti ka paraqitur përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore drejtuar QKR-së, datë 5.10.2009, e cila konfirmon aplikimin e saj për çregjistrim. Edhe në seancë dëgjimore subjekti deklaroi se në vitin 2009 ka paraqitur një kërkesë për çregjistrim, por në vijim ajo nuk e ka ndjekur ecurinë e kësaj kërkesë. Në përfundim, subjekti parashtron se nuk ka qenë dhe as ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, për pasojë nuk ka kryer veprime që cenojnë etikën profesionale.

35.1. Në përfundim të procesit vlerësohet se:

a. Subjekti argumenton dhe këmbëngul që nuk e ka ushtruar asnjëherë aktivitetin e avokates, ndërkohë që ky fakt ka qenë i vërtetuar edhe nga Komisioni.

b. Subjekti nuk ka vijuar të ndjekë procedurat për mbylljen e aktivitetit si avokate, pasi ka bërë një kërkesë për çregjistrimin e tij në vitin 2009, por përkundrazi e ka përdorur aktivitetin në mënyrë të përsëritur për marrjen e disa kredive. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti nuk ka dhënë asnjë parashtrim. Në këto kushte, krijohet bindja se mosveprimet e subjektit për mosçregjistrimin e aktivitetit si avokate, kanë pasur si qëllim marrjen e kredive.

c. Sa i takon konfliktit të interesit (për të cilin në fakt nuk i është kaluar barrë prove), për sa kohë subjekti nuk ka pasur funksion vendimmarrës dhe në kushtet kur është vërtetuar se nuk e ka ushtruar aktivitetin si avokate, mosveprimet e saj për të mbyllur këtë aktivitet gjatë periudhës që ka qenë ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2016 – 2020), nuk u vlerësuan me ndonjë pasojë në kuptim të konfliktit të interesit.

Në lidhje me pasurinë e llojit apartament në Rrugën e Durrësit

36. ILDKPKI-ja ka konstatuar se: (i) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për pagesën e kështit të parë në shumën 3,000,000 lekë, për blerjen e apartamentit me sip. 72.5 m² në Rrugën e Durrësit, Tiranë; (ii) është i paqartë destinacioni i shumës 4,400,000 lekë, përfituar nga disbursimi i kredisë në Credins Bank, pasi shuma e përfituar është tërhequr *cash* nga subjekti, por nuk ka kaluar në llogarinë e palës shitëse si likuidim për kështin e dytë për blerjen e apartamentit; (iii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar, që ka shërbyer për shlyerjen totale të kredisë në datën 5.3.2014, në shumën 4,600,000 lekë.

36.1. Nga hetimi në lidhje me këtë pasuri rezultoi se:

- Sipas kontratës së premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2011¹¹, znj. M. T. i ka blerë shtetas D. T. apartamentin me nr. pasurie ***, me sip. 72.5 m², ndodhur në adresën Rruga e ***, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, kundrejt vlerës 7,000,000 lekë (pasuria është blerë prej

¹¹ Shihni aneksin nr. *** në dosjen ILDKPKI.

shtetases D. T. në vitin 1999). Mënyra e pagesës do të bëhet me dy këste: kësti i parë në vlerën 3,000,000 lekë është paguar jashtë zyrës noteriale, ndërsa likuidimi i këstit të dytë në vlerën 4,000,000 lekë do të bëhet pas lëvrimit të kredisë.

- Me kërkesë të Komisionit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument apo shpjegim për të vërtetuar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të parë në datën 2.5.2011. Shuma prej 3,000,000 lekësh është konsideruar si shpenzim në analizën financiare të periudhës nga 2009 – 28.1.2017, kur janë analizuar kursimet nga pagat.

- Sa i takon këstit të dytë, në kontratë parashikohet se do të likuidohet nëpërmjet një kredie. Sipas kontratës për kredi afatgjatë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2011, znj. Majlinda Tosku ka marrë kredi nga Credins Bank në shumën 4,500,000 lekë, me qëllim blerjen e një apartamenti. Për garantimin e kredisë është vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë nr. ***, apartament në Rrugën e ***, me sip. 72.5 m², në pronësi të shtetases D. T., e cila ka dalë edhe dorëzanëse për garantimin e shlyerjes së kësaj kredie. Kredia është marrë për një afat 240 muaj, e cila është mbyllur përpara afatit në datën 5.3.2014, kur subjekti ka depozituar *cash* 4,600,000 lekë, më përshkrimin “Derdhje për mbyllje kredie”.

- Referuar llogarisë rrjedhëse në Credins Bank, në emër të znj. Majlinda Tosku konfirmohet se në datën 17.5.2011 është disbursuar kredia në shumën 4,455,000 lekë. Në datën 17.5.2011 është tërhequr shuma *cash* 1,000,000 lekë dhe në datën 18.5.2011 është tërhequr shuma 3,400,000 lekë. Nuk ka ndonjë provë që shumat e tërhequra të kenë shërbyer për pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë.

- Nga të dhënat bankare rezulton se në datën 5.3.2014 është derdhur nga subjekti *cash* në Credins Bank shuma 4,600,000 lekë për shlyerje totale kredie.

- Është pyetur subjekti për destinacionin e shumave të tërhequra *cash* dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 nuk ka dhënë sqarime. Ndërkohë, ka deklaruar se për apartamentin objekt vlerësimi ka paguar vetëm këstin e parë prej 3,000,000 lekësh dhe në pamundësi për të paguar këstin e mbetur, nëna gjeti një blerëse e cila mundësoi blerjen e pasurisë. Konkretisht, subjekti ka deklaruar se: “*Kjo pronë nuk ka kaluar asnjëherë në emrin tim. Kam marrë kredi me qëllim që ta blej këtë apartament dhe kam paguar edhe këstin e parë referuar kontratës së premtim shitjes. Me gjithë dëshirën e mirë, nuk pata mundësi financiare për ta paguar të gjithë vlerën sipas kontratës dhe nënës i duheshin të ardhurat nga kjo pronë. Është ofruar një blerës që mund ta paguante të gjithë çmimin e apartamentit dhe unë u tërhoqa nga blerja. Referuar kontratës së shitjes, me cilësinë e blerësit është znj. Z. S. Në lidhje me pronarin aktual nuk e di se kush e gëzon këtë pronë në këto momente, pasi nëna ime ka lidhur kontratë shitjeje në datën 12.3.2014, me palë blerëse znj. Z. S.*”. Po kështu, subjekti deklaroi se: “*Meqë unë kisha marrë kredi pranë Credins Bank në shumën prej 4,600,000 lekësh dhe meqë nuk e finalizova dot, atëherë nëna ime me shitjen e apartamentit të saj ka realizuar edhe mbylljen e kredisë. Me kontratën e kaparit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.3.2014, i është dhënë shuma prej 4,600,000 lekësh dhe çliruar pasurinë nga barra hipotekore*”.

Sa i takon të ardhurave të përfituara nga kapari i marrë prej nënës së subjektit nga shitja e apartamentit në Rrugën e *** shtetases Z. S., subjekti ka vënë në dispozicion:

i) Kontratën e kaparit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.3.2014, sipas së cilës shtetasja D. T. i shet blerëses Z. S. pasurinë nr. ***, apartament me sip. 72.5 m², ndodhur në Rrugën e ***. Palët deklarojnë se duke qenë se znj. S. nuk po e paguan të gjithë vlerën e blerjes së apartamentit, ajo po i jep *cash* në zyrën noteriale të noteres M. D. shumën 4,600,000 lekë, konvertuar në euro. Në këtë kontratë nuk është shënuar vlera e plotë me të cilën do t’i shitet ky apartament znj. S.

ii) Kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.3.2014, me të cilën shtetasja D. T. i shet blerëses Z. S. pasurinë nr. ***, në çmimin 70,000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në lidhje me këtë pasuri, FSHU-ja ka informuar që në vitin 2014 është lidhur kontrata e furnizimit me energji në emër të blerëses Z. S. I është kërkuar me shkresë origjina dhe transaksionet e kësaj pasurie ASHK-së dhe nuk është dërguar informacion. Subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore regjistrimi i pasurisë në emër të znj. Z. S., si dhe statusi juridik aktual i saj. Në parashtrime ka deklaruar se e ka objektivisht dhe ligjërisht të pamundur të sigurojë dokumentacion ligjor në lidhje me këtë pronë mbi të cilën nuk ka pasur të drejta reale.

Nga Komisioni u verifikuan dy kontratat e përpiluara nga noterja M. D. dhe u konstatua se në regjistrin noterial përshkrimi i pasurisë objekt i kontratave nuk është pasqyruar në rubrikën përkatëse, si dhe ka një korrigjim në shënimin “Kontratë kapari”.

36.2. Në përfundim të hetimit në lidhje me pasurinë nr. ***, apartament i porositur me kontratë premtim shitjeje nga ana e subjektit, duket se:

- Subjekti nuk e ka përdorur shumën prej 4,500,000 lekësh, të përfituar nga kredia e marrë në vitin 2011 për blerjen e pasurisë sipas parashikimit në kontratën e premtim shitjes. Është i pavërtetuar destinacioni i përdorimit të kësaj shume.

- Është i pavërtetë deklarimi i subjektit se ka paguar vetëm këstin e parë prej 3,000,000 lekësh në vitin 2011, për shkak se ka qenë në pamundësi për të paguar këstin e mbetur (për këtë arsye nëna gjeti një blerëse e cila mundësoi blerjen e pasurisë), pasi rezultoi që ajo ka marrë kredinë në datën 10.5.2011, pra brenda të njëjtit muaj që është lidhur kontrata e premtim shitjes në datën 2.5.2011, ndërkohë që kontrata e kaparit me shtetasen Z. S. është lidhur në vitin 2014.

Në këto kushte, duket se kontrata e premtim shitjes e vitit 2011, lidhur midis subjektit dhe nënës së saj, është lidhur fiktivisht vetëm për të marrë kredinë.

Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si më sipër.

36.3. Në parashtrimet e veta subjekti deklaroi se shuma e marrë nga kredia është paguar si këst i parë i kontratës së premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2011. Pavarësisht se në këtë kontratë thuhet se vlera prej 3,000,000 lekësh është paguar jashtë kësaj zyre, kredia e marrë në datën 10.5.2011 është përdorur pikërisht për këtë këst sipas kontratës. Siç vërehet për herë të parë në parashtrime, subjekti paraqet variantin e pagimit të shumës 3,000,000 lekë me kredinë e marrë në datën 10.5.2011, duke e argumentuar këtë me faktin se: *“Nëna ime (shitësi) e dinte që kisha aplikuar për kredi e po kështu e dinte që kishim çuar në bankë gjithë dokumentacionin e kërkuar nga banka për të marrë këtë kredi, kështu që mënyra sesi e hartonte noteri kontratën nuk përbënte problem për asnjë nga palët, nisur kjo edhe nga marrëdhënia shumë e ngushtë prind-fëmijë. Referuar kontratës së premtim shitjes, nuk ka të përcaktuar afat kohor se kur do të paguhej kësti i dytë”*.

Më tej subjekti vijon se: *“Me kalimin e kohës kuptova se ishte shumë e vështirë të përballoja e vetme edhe kredinë edhe jetesën dhe të mendoja për të shlyer edhe pjesën e mbetur të çmimit të apartamentit. U dorëzoja për t’ia dalë mbanë kësaj pune dhe nëna gjeti një blerëse e cila mundësoi blerjen e pasurisë”*. Po kështu, subjekti i referohet faktit se me të ardhurat nga kontrata e kaparit, nënshkruar në datën 5.3.2014, po në këtë datë ka derdhur në Credins Bank shumën prej 4,600,000 lekësh për shlyerje totale të kredisë. Subjekti në përfundim kërkon që shumën prej 3,000,000 lekësh Komisioni ta heqë si shpenzim në analizën financiare të periudhës 2009 – 28.1.2017.

36.4. Në analizë të parashtrimeve, në përfundim të procesit në lidhje me apartamentin objekt verifikimi, u konstatua se subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, arsyetuar si vijon:

a. Pretendimi se shumën e përfituar nga kredia prej 4,600,000 lekësh, e marrë në datën 10.5.2011, e ka përdorur për pagimin e kështit të parë prej 3,000,000 lekësh sipas kontratës së premtim shitjes në datën 2.5.2011, përveçse është paraqitur për herë të parë në parashtrime dhe është në kundërshtim me deklaratimet e mëparshme, bie në kundërshtim me kontratën e premtim shitjes, e cila përcakton shprehimisht se *mënyra e pagesës do të bëhet me dy këste: kësti i parë në vlerën 3,000,000 lekë është paguar jashtë zyrës noteriale, ndërsa likuidimi i kështit të dytë në vlerën 4,000,000 lekë do të bëhet pas lëvrimit të kredisë.*

Nga ana tjetër, ky pretendim bëhet akoma më i pabazuar edhe për faktin se subjekti e ka pasur të gjithë mundësinë që shumën 4,600,000 lekë të përfituar me kredi ta paguante për blerjen e pasurisë, ndërkohë që sipas parashtrimeve vetëm 3,000,000 lekë i ka dhënë nënës për blerjen e pasurisë, duke lënë të paqartë përse është përdorur pjesa tjetër. Për më tepër, është vërtetuar tërheqja pjesë - pjesë e shumës së disbursuar të kredisë (në datën 17.5.2011 është tërhequr shuma *cash* prej 1,000,000 lekësh dhe në datën 18.5.2011 është tërhequr shuma prej 3,400,000 lekësh), çka e bën akoma më të pabesueshëm pretendimin se *kredia e marrë në datën 10.5.2011 është përdorur pikërisht për këtë kësht (prej 3,000,000 lekësh).*

b. Është i pajustificuar pretendimi i subjektit në seancë dëgjimore se pjesa e mbetur e kredisë, pasi pagoi shumën prej 3,000,000 lekësh, është mbajtur me qëllim për të bërë shlyerjen e kësteve të kredisë, pasi ajo ka pasur një pagë modeste kur ishte e punësuar në DPA (pretendim i përsëritur edhe në raste të tjera).

c. Mbetet i pavërtetuar pretendimi që shuma prej 4,600,000 lekësh, e përfituar nga nëna e subjektit nëpërmjet kontratës së kaparit lidhur në datën 5.3.2014 me nr. *** rep., nr. *** kol., është përdorur për shlyerjen e kredisë në *cash* nga subjekti, për sa kohë kjo shumë nuk ka kaluar në llogarinë e noteres M. D. sipas udhëzimit nr. ***, datë 30.1.2012 “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”. Edhe në rastin e përfitimit *cash* të shumës 4,600,000 lekë nga nëna e subjektit, sikurse parashikon kontrata e kaparit, kjo shumë nuk ka kaluar nëpërmjet sistemit bankar për shlyerjen e kredisë që subjekti ka marrë nga Credins Bank.

Sa më sipër, mbetet i pavërtetuar destinacioni i kredisë së marrë me kontratën e kredisë në datën 10.5.2011, si dhe burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj kredie.

36.5. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes u vlerësua se:

Në kushtet kur subjekti nuk ka pasur të ardhura për pagesën e shumës 3,000,000 lekë në ditën e lidhjes së kontratës së premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2011 dhe nuk e ka përdorur kredinë e marrë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2011, për blerjen e apartamentit objekt i kontratës për premtim shitje, në përfundim të procesit vlerësohet se: (i) kontrata e premtim shitjes e lidhur midis subjektit dhe nënës së saj është lidhur fiktivisht vetëm për të marrë kredinë; (ii) në përpjekje për të kundërshtuar këtë fakt subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore dhe që bien ndesh me faktet dhe provat e administruara; (iii) në këto kushte, shuma 3,000,000 lekë duhet të hiqet si shpenzim nga analiza financiare për periudhën 2009 – 28.1.2017, balanca negative e së cilës nga -15,197,368 lekë bëhet -12,197,368 lekë. Për më tepër, në mënyrë të përsëritur subjekti ka marrë një kredi, destinacioni i së cilës mbetet i pavërtetuar.

37. Nga Komisioni u kërkuan të dhëna për pasuri në emër të prindërve të subjektit dhe nga të dhënat e FSHU-së, të marra nëpërmjet *email*-it të datës 11.12.2023, rezulton se babai i subjektit Kujtim Tosku ka dy pasuri me status aktiv, një në Rrogozhinë dhe një në Elbasan, të cilat janë

aktive që nga viti 2007 dhe për të cilat nuk është parë e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore.

38. Nga Komisioni u kryen verifikime për dy transaksione të paqarta që subjekti ka kryer pranë BKT-së, përkatësisht në datat 19.5.2011 dhe 11.7.2012. Në lidhje me transaksionin e datës 11.7.2012, me përshkrimin “Tërheqja e lekëve nga llogaria e A. T.”, është pyetur subjekti për këtë llogari dhe nëse ka pasur llogari bankare dyemërore për të kryer këtë veprim. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti në lidhje me këtë pyetje ka deklaruar se ajo nuk ka pasur llogari dyemërore, mirëpo ka vënë në dispozicion të Komisionit prokurën e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.4.2012, në të cilën vëllai i saj A. T. i ka dhënë Majlinda Toskut kompetenca dhe të drejta për të nënshkruar kontratë huaje dhe hipoteke në emër të tij, për marrje kredie në emrin e tij, për të tërhequr vlerën e kredisë, për të bërë bllokimin e pronave në emër të tij në ZRPP, si dhe për të firmosur çdo dokument apo akt noterial për të marrë kredi bankare. Sipas të dhënave bankare në BKT, rezulton se subjekti për periudhën 12.6.2013 – 30.12.2016 ka kryer pagesa kësti kredie për shtetasin A. T., në shumën totale prej 374,500 lekësh. Siç vërehet, në rastin konkret vëllai i subjektit A. T. ka marrë një kredi në emër të vet, ndonëse si përfaqësuese ka lënë subjektin Majlinda Tosku, duke lënë të paqartë dhe të pajustificuar faktin përse në rastet e kredive të trajtuara më sipër lidhja e kontratave është bërë nga subjekti në cilësinë e kredimarrëses, ndërkohë që qëllimi ka qenë ushtrimi i aktivitetit të biznesit të vëllezërve të saj.

39. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se jeton me dy fëmijët e saj të lindur në datën 1.9.2021. Në certifikatën familjare¹² rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dy fëmijë binjakë të lindur në këtë datë. Me *email*-in e datës 14.11.2023 i është kërkuar subjektit të vërë në dispozicion emrin e babait të fëmijëve dhe gjeneralitetet e tij të plota, duke dhënë sqarime për bashkëjetesën me të dhe periudhën përkatëse. Me *email*-in e datës 15.11.2023 subjekti ka deklaruar se ajo nuk ka bashkëjetuar dhe as nuk bashkëjeton me babain e fëmijëve të saj G. Ll. dhe ka vënë në dispozicion identitetin e tij të plotë.

Duke qenë se kjo përgjigje nuk ka qartësuar në lidhje me marrëdhënien me këtë shtetas, me *email*-in e datës 12.1.2024 subjektit iu kërkuar të informojë në lidhje me marrëdhëniet që ka pasur dhe ka me këtë shtetas, periudhën/periudhat e tyre, si dhe vendbanimin e tij ndër vite deri më sot. Po kështu i është kërkuar të informojë në lidhje me dy mjetet me të cilat ai ka udhëtuar jashtë shtetit. Në përgjigjen e dërguar me *email*-in e datës 15.1.2024 subjekti ka deklaruar se me babain e fëmijëve të saj është njohur në shtator të vitit 2022. Nga kjo marrëdhënie kanë lindur binjakët Parid e M. L., të datëlindjes 1.9.2021. Aktualisht marrëdhënia me të është e shumë e mirë për shkak të fëmijëve. Për sa i takon vendbanimit të tij, në dijeninë e saj ai ka jetuar jashtë shtetit kohë më përpara, ndërsa aktualisht ai jeton me vëllain e tij në Tiranë në adresën bulevardin “****”, ap. ***. Subjekti ka dhënë shpjegime edhe në lidhje me dy mjete që ka udhëtuar shtetasi G. Ll..

Nga ana e Komisionit është kërkuar informacion në lidhje me procedime të shtetasit G. Ll. dhe SPAK-u¹³ ka informuar se nuk ka të dhëna për procedime penale ndaj këtij shtetasi. Nuk rezultojnë udhëtime të subjektit me këtë shtetas në sistemin TIMS. Në këto kushte, nuk janë kryer verifikime të mëtejshme për këtë shtetas.

40. Në lidhje me udhëtimet në sistemin TIMS, subjektit me *email*-in e datës 12.1.2024 i janë kërkuar të dhëna në lidhje me pronarët e mjeteve dhe qëllimin e udhëtimeve, e cila me *email*-in e datës 15.1.2024 ka dhënë shpjegime për udhëtimet e kryera dhe qëllimet e tyre, si dhe pronarët e automjeteve. Për sa i takon shpenzimeve të kryera gjatë udhëtimeve jashtë vendit, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit në shumën 353,275 lekë. Shpenzimet për udhëtimet jashtë shtetit

¹² Bashkëlidhur në dokumentet që janë dërguar në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

¹³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2023, të dërguar nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

(TIMS) u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit të dhëna në *email*-in e datës 15.1.2024. Për llogaritjen e shpenzimeve Komisioni i është referuar deklaratimeve të subjektit në lidhje me destinacionin dhe standardin e vendosur nga Kolegji në lidhje me çmimet e biletave dhe shpenzimeve ditore të qëndrimit. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për qëndrimin në Itali te miqtë, si dhe dokumentacion provues për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të një udhëtimi të organizuar nga institucioni ku ka punuar.

KONTROLLI I FIGURËS

41. Nga akte të vëna në dispozicion nga AKSIK-ja subjekti ka rezultuar i përshtatshëm për ushtrimin e detyrës, konfirmuar me raportin nr. ***, datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së datë 15.2.2022. Nuk kanë rezultuar pasaktësi në plotësimin e formularit të figurës. Pas kërkimeve, nuk kanë rezultuar të dhëna të përditësuara për subjektin e rivlerësimit. Gjatë hetimit administrativ:

- Nuk u evidentuan kontakte të papërshtatshme me persona që subjekti ka udhëtuar sipas sistemit TIMS, pasi për shtetasit M. L., O. H., A. L., Dh. L.¹⁴ dhe O. Th. Dh. nuk ka të dhëna për procedime penale për vepra të krimit të organizuar.

- Nuk u evidentuan të dhëna për veprimtari të kundërligjshme në shtetin italian për vëllezërit e subjektit A. e G. T., të cilët sipas subjektit banojnë prej vitesh në Itali. Po kështu, SPAK-u¹⁵ ka informuar se në emër të shtetasve A. T. e G. T. (vëllezërit e subjektit) dhe K. T. (babai) nuk ka të regjistruara procedime penale.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku është e përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

42. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me nr. *** prot., datë 27.2.2023, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 1.3.2023; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas pikës 2 të nenit 42 parashikohet se *këshilltari ligjor i Gjykatës Administrative, i cili nuk është magjistrat, vlerësohet bazuar në: (i) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura, për të cilat është shprehur raporti i KLGJ-së; (ii) rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës.* Referuar shkresës nr. *** prot., datë 23.5.2018, të dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se subjekti ka marrë në total 106 pikë (45 pikë në testin e përgjithshëm dhe 61 pikë në testin profesional).

Raporti për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja

¹⁴ Ky shtetas është proceduar në gjendje të lirë për veprën penale të falsifikimit.

¹⁵ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 5.12.2023 dhe nr. *** prot., datë 26.12.2023, të dërguar nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

43. Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit në të gjithë elementet përbërëse të tij, tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore sipas të cilave gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016” për subjektin Majlinda Tosku nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së, ndërsa sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

44. Sipas raportit të KLGJ-së, nga aktet e vëna në dispozicion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk rezultojnë akte administrative të nënshkruara nga ndihmësja ligjore, znj. Majlinda Tosku, të tilla si “relacione”, “draftvendime”, “opinione ligjore” etj. Në bazë të shkresës nr. *** prot., datë 4.8.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezultoi se znj. Majlinda Tosku është emëruar ndihmës ligjore pranë kësaj Gjykate në datën 7.6.2016 dhe në bazë të urdhrit nr. *** datë 13.6.2016, të Kryetarit të Gjykatës, ajo është caktuar të asistojë gjyqtarin A. S. Në përmbajtje të shkresës nr. *** prot., datë 4.8.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasqyrohet fakti se: *“Sjell në vëmendjen Tuaj, se për sa i përket dokumenteve ligjore të ndihmësve, theksoj se ne nuk disponojmë, marrëdhënia midis gjyqtarit dhe ndihmësve përkatës nuk ka qenë e rregulluar me udhëzim apo rregullore të posaçme”*. Në nenin 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, detajohen detyrat e ndihmësit ligjor, ku shprehimisht thuhet: *“Ndhmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkitime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”*.

45. Në pjesën e parë të këtij raporti, është parashtruar se ndihmësja ligjore, znj. Majlinda Tosku, lidhur me detyrat e kryera prej saj si ndihmëse ligjore, ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit profesional si vijon: *“Gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmës ligjor kam punuar për 312 dosje gjyqësore me projektakte dhe projektvendime të caktuara nga gjyqtarët përkatës”*. Gjithashtu, në pjesën e parë të raportit janë relatuar tri projektvendime të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, prej nga rezulton se ndihma e saj për gjyqtarin pranë të cilit ka punuar ka konsistuar në hartimin e “projektvendimeve”. Mirëpo projektvendimet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku, nuk gjenden në dosjet gjyqësore përkatëse, pasi aktet procedurale të dosjes, përfshirë vendimet gjyqësore, duhet të nënshkruhen vetëm nga gjyqtari dhe jo nga ndihmësi. As neni 6, pika e ligjit nr. 49/2012, por asnjë dispozitë tjetër ligjore apo akt nënligjor, nuk parashikon që në dosjen gjyqësore të përfshihen “projektakte procedurale” të përgatitura nga ndihmësi ligjor. Gjithashtu, rezultoi se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në periudhën objekt i këtij vlerësimi profesional (8.10.2013 – 8.10.2016), nuk ka miratuar ndonjë rregullore me të cilën të normonte apo dokumentonte në njëfarë mënyre punën, asistencën e ndihmësve ligjorë që kanë ushtruar detyrën pranë asaj gjykate në atë periudhë kohore. Mungesa e një kuadri ligjor apo nënligjor për të normuar, dokumentuar apo gjurmuar punën e kryer nga ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, nuk mund të penalizojë këta të fundit dhe nuk mund të vihet në diskutim kontributi që ndihmësit ligjorë kanë dhënë në mbarëvajtjen e punës pranë gjyqtarëve të cilët kanë asistuar.

46. Sa i takon të dhënave arkivore, në raportin e KLGJ-së pasqyrohet se për subjektin e rivlerësimit Majlinda Tosku nuk ka të dhëna në burimet arkivore të këtij institucioni për periudhën e rivlerësimit, për shkak se ndihmësit ligjorë ishin njësi e brendshme, e organizuar dhe vareshin nga gjykatat administrative ku ushtronin detyrën. Për rrjedhojë, të dhënat profesionale dhe etike për

këtë subjekt i kemi marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ku ajo ka ushtruar detyrën si ndihmëse ligjore.

47. Në përfundim të raportit, KLGJ-ja ka vlerësuar subjektin si më poshtë:

47.1. Për aftësitë profesionale

- Për të vlerësuar njohuritë ligjore raporti i është referuar nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 165 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave për kohën kur kryhet procesi i vlerësimit profesional, për ndihmësit ligjorë, ndryshe nga magjistratët-gjyqtarë, nuk ka pasur të miratuar nga një organ kompetent një Sistem Vlerësimi Profesional. Për rrjedhojë, për ndihmësit ligjorë në gjykatat administrative nuk ka kriteret matëse të punës, sikurse ato kanë ekzistuar për magjistratët-gjyqtarë, prandaj vlerësimi i aftësive profesionale të tyre nuk ndjek detyrimisht të njëjtat rregulla, sikurse për magjistratët-gjyqtarë. Në këto kushte, vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësve ligjorë pranë gjykatave administrative do të kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 të sipërcituar, si dhe bazuar në përmbajtjen e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar më vonë. Duke iu referuar të dhënave për eksperiencën në punë për subjektin e rivlerësimit, mund të themi se subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku ka eksperiencë në fushën e drejtësisë.

- Për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, në cilësinë e ndihmës ligjore, në raport është shprehur se, bazuar në “3 dokumentet ligjore” të prezantuar nga vetë subjekti, si dhe “5 dokumenteve të përzgjedhura me short”, mund të konkludojmë se: *“Subjekti i rivlerësimit, znj. Majlinda Tosku, në projektvendimet e përpunuara prej saj, manifeston njohuritë e duhura ligjore për të prezantuar saktë çështjen objekt gjykimi, duke rreshtuar, por dhe analizuar pretendimet dhe prapësimet e palëve, duke identifikuar drejt legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes dhe jep propozim konkret për gjyqtarin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, si dhe duke përgatitur projektvendimin në përputhje me udhëzimet e gjyqtarit që ajo ka asistuar. Në tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit spikasin njohuritë e saj në lidhje me: dispozitat e ligjit nr. 49/2012, “Ligjin për gjykatat administrative...”; dispozitat e Kodit të Procedurës Civile; dispozitat e ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002, “Për prefektin; dispozitat e ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe shpëtimit”; dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”; dispozitat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë etj.”.*

47.2. Për aftësitë organizative

- Për aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, është evidentuar se subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku rezulton se ka ushtruar detyrën e ndihmës ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga data e emërimit të saj 7.6.2016 e në vazhdim. Në funksionin e ndihmës ligjor pranë kësaj gjykate, ajo ka deklaruar se në periudhën korrik 2016 – tetor 2016, i janë caktuar dhe ka përfunduar 312 projektvendime dhe akte të tjera procedurale të kërkuara nga gjyqtari që ajo ka asistuar. Këto të dhëna statistikore janë deklaruar nga vetë subjekti në formularin e vetëvlerësimit profesional. Ndërsa, sipas informacionit zyrtar të paraqitur nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për efekt të organizmit të përzgjedhjes së 5 çështjeve me short rezulton se për periudhën 7.6.2016 – 8.10.2016 subjekti i rivlerësimit ka asistuar gjyqtarin A. S., duke përpiluar gjithsej 234 akte (projektvendime gjyqësore). Duhet evidentuar fakti se për subjektin e rivlerësimit, nuk ka të dhëna direkte për ngarkesën dhe punën e saj, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të gjyqtarit pranë të cilit ajo është caktuar të asistojë. Kuadri ligjor në fuqi për kohën kur kryhet ky vlerësim profesional nuk përcakton standarde minimale pune për

ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Nga të dhënat statistikore të deklaruara nga vetë ndihmësja ligjore, znj. Majlinda Tosku, por edhe ato të dhëna të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për efekt të shortit, mund të themi se subjekti i rivlerësimit ka përballuar një ngarkesë mesatare pune dhe ka përfunduar në kohë detyrat e ngarkuara nga gjyqtari të cilin ka asistuar.

- *Për aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore*, detyrat e ndihmësit ligjor të gjykatave administrative janë parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 dhe konkretisht në paragrafët 1 e 2 të tij, ku sanksionohet se: (i) gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe i Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor; (ii) ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projektakte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim. Rezulton qartë nga përmbajtja e ligjit të sipërcituar se ndihmësi ligjor nuk kryen procedura gjyqësore. Ky kriter vlerësimi shërben dhe zbatohet vetëm për gjyqtarin, i cili ka të përcaktuara qartësisht në ligj detyrat e tij procedurale, duke filluar që nga data e marrjes me short të çështjes e deri në datën e përfundimit të saj me vendim përfundimtar.

- *Për aftësinë për të administruar dosjet*, sipas raportit edhe ky kriter vlerësimi zbatohet vetëm për gjyqtarët. As në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe në asnjë ligj apo akt nënligjor tjetër nuk parashikohet si detyrë për ndihmësin që të administrojë një dosje gjyqësore.

47.3. Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

- *Për etikën në punë* – Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të znj. Majlinda Tosku, për periudhën gjatë së cilës ajo ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor pranë asaj gjykate (7.6.2016 – 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje discipline.

- *Për integritetin* – Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku, nga të dhënat e dërguara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

- *Për paanësinë* – Ky element vlerësues është tipik për gjyqtarin, i cili ka detyrimin ligjor jo vetëm të jetë i paanshëm në një proces gjyqësor, por edhe duhet të silllet si i tillë sipas parimit “Drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se po jepet”. Ndihmësi ligjor nuk ka kontakte me palët ndërgjyqëse, pasi nuk është pjesëmarrës në një proces gjyqësor dhe as subjekt procedural. Ndihmësi ligjor nuk është organ vendimmarrës, por këshillues, asistues i gjyqtarit. Në tri projektvendimet e përgatitura nga ndihmësja ligjore Majlinda Tosku nuk konstatohen elemente favorizuese apo njëanshmërie në raport me palët ndërgjyqëse pjesëmarrëse në ato procese gjyqësore që u korrespondojnë atyre projektvendimeve.

47.4. Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

Për aftësitë e komunikimit – Në të 8 dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të

natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në aktet e përpiluara prej saj mund të vlerësohet si korrekte dhe normale.

Për aftësinë për të bashkëpunuar – Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, me kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë në asnjë prej projektvendimeve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtarin të cilin ka asistuar.

Për gatishmërinë për t'u angazhuar – Subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti Shtetëror i Tiranës në datën 31.1.2004. Në vitin 2005, znj. Majlinda Tosku ka marrë titullin “Avokat” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë e Republikës së Shqipërisë. Për një periudhë 6-vjeçare (shkurt 2009 – mars 2015), subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e juristit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë. Znj. Majlinda Tosku është emëruar si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë në datën 7.6.2016. Subjekti i rivlerësimit Majlinda Tosku ka marrë pjesë dhe është certifikuar vetëm në një trajnim të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës. Pjesëmarrja e ulët në trajnime në Shkollën e Magjistraturës nuk është për faj të znj. Majlinda Tosku, pasi ajo gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional ka punuar 6 muaj gjithsej si ndihmëse ligjore. Në periudhën që znj. Majlinda Tosku ka punuar juriste nuk merrte dot pjesë në seminarët e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Megjithatë, rezultoi se znj. Majlinda Tosku ka treguar mjaft interes në marrjen pjesë në trajnime gjatë kohës që ajo ka ushtruar detyrën e juristes pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kështu, rezultoi nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit se znj. Majlinda Tosku, në cilësinë e juristes, ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 12 trajnime të natyrave të ndryshme.

48. Sa i takon informacionit të marrë nga burime të ligjshme, për subjektin është administruar vetëm një denoncim nga shtetasi N. Ç., pretendimet e të cilit janë shqyrtuar gjatë hetimit administrativ.

49. Bazuar në sa më sipër, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “e aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

SEANCA DËGJIMORE

50. Në datën 9.2.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit Majlinda Tosku, në përfundim të së cilës ajo kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit dhe shpalli vendimin në seancën e datës 13.2.2024, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

51. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe e ka dëgjuar atë në seancë dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë e gatshme në kthimin e përgjigjeve, por janë evidentuar qëndrime kontradiktore me deklarime të mëparshme, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I ÇËSHTJES

52. Në procesin e vendimmarrjes, Komisioni është bazuar në konstatimet në lidhje me kriterin pasuror dhe në vlerësimin tërësor të procedurave sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave dhe, në përfundim, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, arsyetuar si vijon:*

52.1. Në pikën 3 të tij, neni 61 i ligjit nr. 84/2016 parashikon një nga rastet e marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjekteve, që është deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Pika 5 e kësaj dispozite ligjore parashikon se kryerja e verifikimeve në lidhje me kriterin pasuror është në funksion të evidentimit nëse: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; (b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) është kryer fshehje e pasurisë; (ç) është kryer deklarim i rremë.

Në interpretim strikt të kësaj dispozite ligjore, në përfundim të procesit, gjatë vlerësimit të së vetmes deklaratë të subjektit, asaj *Vetting*, u konstatua se subjekti:

a. Sipas shkronjës “a”, ka kryer deklarime të pasakta dhe që bien në kundërshtim me ligjin, pasi: (i) nuk ka deklaruar përdorimin dhe posedimin e pasurisë nr. ***, për të cilën për shkak të rrethanave të konstatuara në lidhje me këtë pasuri mbi të cilën është sjellë si pronare, është vlerësuar se ka fshehur përdorimin e pasurisë; (ii) nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara në rrugë bankare nga dhënia me qira e kësaj pasurie, si dhe nuk ka kryer asnjë deklarim në lidhje me faktin se këto të ardhura nuk i takojnë asaj por nënës së saj, sikurse ka pretenduar gjatë procesit të rivlerësimit.

b. Sipas shkronjës “b”, nuk justifikon tërësisht me të ardhura të ligjshme likuiditetin në *cash* prej 1,500,000 lekësh të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në lidhje me mosjustifikimin e likuiditetit në *cash* prej 600,000 lekësh, pjesë përbërëse e likuiditetit të deklaruar prej 1,500,000 lekësh, u vërtetua se kjo ka ardhur si pasojë e balancës negative prej -15,197,368 lekësh (në përfundim të procesit ndryshoi në -12,197,368 lekë), që i përket periudhës që subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues. Është e vërtetë që barra e provës nuk i ka kaluar në mënyrë specifike në lidhje me këtë balancë negative, por, duke qenë se kjo balancë ka qenë shkak i pamundësisë financiare të likuiditetit në *cash* prej 600,000 lekësh, vlerësohet se subjekti duhet të kishte dhënë parashtrime për ta kundërshtuar atë, e cila më së shumti është afektuar nga konsiderimi i shumave që kanë shkuar për shlyerjen e kredive si shpenzime të saj. Në deklaratimet e saj lidhur me kreditë pranë Fondit Besa, subjekti pohon se shlyerja e kredive në një rast është bërë me të ardhurat e përfituara nga kredia e marrë, veprim i pajustificuar financiarisht por edhe objektivisht referuar fakteve dhe provave arsyetuar më sipër në këtë vendim, dhe në raste të tjera deklaroi se është bërë me të ardhura të vëllezërve, për të cilat nuk paraqiti asnjë dokument provues.

Megjithatë, sa i takon pamundësisë financiare për të krijuar likuiditetin në *cash* prej 600,000 lekësh, si rrethanë më vete ky fakt nuk përben shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, por është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në raport me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në posedim/përdorim, që sipas pikës 5 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës përbën shkak që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

52.2. Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin 22, datë 16.9.2019¹⁶, i cili ka aplikuar nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit pasuror dhe vendimin nr. 31, datë 20.11.2019¹⁷, në përfundim të procesit u vlerësua se me veprimet dhe mosveprimet e saj subjekti ka dështuar të provojë se është një figurë e besuar për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë, që e vë atë në kushtet e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i referohet të gjitha konstatimeve të analizuar hollësisht më sipër në këtë vendim, që në mënyrë të përmbledhur i referohen fakteve dhe rrethanave të poshtëshënuara.

a. Në lidhje me kreditë e marra nga Fondi Besa, deklaratimet e subjektit gjatë procesit kanë qenë kontradiktore dhe vlerësohen nga Komisioni si një përpjekje e saj për të fshehur qëllimin e vërtetë të marrjes së tyre dhe për të justifikuar veprimet dhe mosveprimet si vijojnë:

- subjekti në mënyrë të përsëritur ka marrë kredi për investime në aktivitete private të cilat nuk rezultojnë të jenë ushtruar prej saj apo familjarëve të saj;
- ka kryer në mënyrë të përsëritur deklaratime të rreme në formularët e marrjes së kredive;
- nuk vërtetohet destinacioni i përdorimit të shumave të përfituara nga kreditë dhe nëpërmjet deklaratimeve kontradiktore, e që bien në kundërshtim me fakte dhe rrethana të vërtetuara gjatë hetimit administrativ. Subjekti në mënyrë të përsëritur ka ndryshuar destinacionin e përdorimit të tyre;
- nuk vërtetohen deklaratimet e subjektit se shlyerja e disa kredive është me të ardhurat e vëllezërve të saj. Në një rast është i pajustificuar përdorimi i kredisë për shpenzime jetese dhe në një rast tjetër është e pajustificuar dhe e pavërtetuar shlyerja e një kredie me të ardhurat e përfituara prej saj.

b. Në lidhje me aktivitetin person fizik – avokate, i cili nuk është ushtruar asnjëherë prej subjektit dhe për të cilin vijon të jetë debitore, znj. Majlinda Tosku nuk ka bërë asnjë përçapje për çregjistrimin e ushtrimit të tij pas kërkesës që vetë ka paraqitur në QKB në vitin 2009, përkundrazi, e ka përdorur në mënyrë të përsëritur me qëllim marrjen e disa kredive të biznesit, destinacioni i të cilave mbeti i paprovuar sipas parashikimit në kontratat përkatëse të kredive, nëpërmjet veprimeve të cilat konsiderohet të jenë kryer në mashtim të ligjit.

c. Sa i takon kontratës së premtim shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.5.2011, të lidhur me nënën e saj D. T., u vërtetua se është lidhur në mënyrë fiktive vetëm për efekt të lidhjes së kontratës për kredi afatgjatë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.5.2011, destinacioni i së cilës mbeti i paprovuar. Në lidhje me përdorimin e kësaj kredie, në parashtrime subjekti ka kryer deklaratime kontradiktore krahasuar me deklaratime të mëparshme të saj, si dhe me fakte të administruara gjatë procesit.

ç. Në një vlerësim tërësor të të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit u konstatua se: (i) subjekti nuk është koherente me deklaratime të mëparshme të saj dhe as me fakte të vërtetuara gjatë hetimit administrativ, duke i ndryshuar ato vazhdimisht; (ii) në mënyrë të përsëritur i është shmangur dhënies së përgjigjeve në lidhje me disa nga konstatimet e Komisionit; (iii) në çdo rast i është shmangur kryerjes së veprimeve nëpërmjet llogarive bankare në të cilat gjen pasqyrim vetëm disbursimi i shumave të përfituara nga kreditë dhe, për më tepër, të gjitha shlyerjet e kredive janë bërë në formë *cash* prej saj.

52.3. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmon se:

¹⁶ Shihni paragrafin 67 të vendimit.

¹⁷ Shihni paragrafët 54 dhe 55 të vendimit.

Është e vërtetë që subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues përpara plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe për pasojë, trupi gjykues ka qenë në pamundësi objektive dhe ligjore për të vlerësuar në lidhje me pasuritë e subjektit përpara kësaj periudhe, duke u fokusuar vetëm në sjelljet e subjektit të rivlerësimit në raport me faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ. Po kështu, është e vërtetë se subjekti nuk e ka statusin e magjistratit, me qëllim vlerësimin e kriterëve që kanë lidhje me etikën dhe integritetin e magjistratëve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magjistratëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht nenit 4 që përcakton standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes apo dispozitave të tjera ligjore/referencave të përdorura për subjektet e rivlerësimit që janë magjistratë. Por, pavarësisht këtyre fakteve, znj. Majlinda Tosku është subjekt rivlerësimi dhe, si i tillë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Neni 2 i këtij ligji sanksionon qartësisht qëllimin e tij: *përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisht së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.*

Në përmbledhje të sa më sipër është arsyetuar, Komisioni çmon se për sa i përket kualifikimit ligjor të fakteve objekt hetimi, pasqyruar hollësisht në këtë vendim, shqyrtimi dhe vlerësimi për subjektin Majlinda Tosku është bërë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar përfundimisht se sjelljet e znj. Majlinda Tosku/veprimet dhe mosveprimet e saj, si përpara plotësimit të deklaratës *Vetting* ashtu edhe gjatë procesit të rivlerësimit, bien ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet prej subjekteve të rivlerësimit si pjesë përbërëse e Sistemit të Drejtësisë, të cilët edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdesen që sjellja e tyre të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtrojnë dhe të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdolloji, sikurse ka ndodhur në rastin e subjektit. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit në obligim të nenit 43, pika 3 dhe nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, nuk ka vënë në dispozicion dokumente shkresore për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit në lidhje me të gjitha kreditë e marra dhe të shlyera prej saj, dhe jo vetëm, si dhe në përpjekje për të justifikuar veprimet/mosveprimet e saj ka kryer në mënyrë të përsëritur deklarime kontradiktore duke vështirësuar punën e Komisionit.

Sikurse Kolegji ka arsyetuar edhe në rastin e subjektit A. Y., ndihmës ligjor, këto rrethana e çojnë subjektin e rivlerësimit në situatën e mosmarrjes së masave të arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, me veprimtarinë e tij të ushtruar jashtë funksionit të tij zyrtar duke arsyetuar se: *Kjo sjellje e tij procedurale dhe ligjore e bën të cenueshëm besimin e publikut tek ai, si pjesë e Sistemit të Drejtësisë dhe është e cenueshme sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84 2016, duke iu referuar nenit 3, pikat 1 dhe 5, si dhe nenit 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, për referencë fakti, shkaku dhe pasojë, si dhe neneve 40, 41/4 dhe 43/1 të ligjit nr. 84/2016.*

Në këto kushte, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84 2016, subjekti ka cenuar besimin e publikut në Sistemin e Drejtësisë në mënyrë të përsëritur e vijuese, duke bërë që të ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Po kështu, subjekti me sjelljen e saj gjatë procesit të rivlerësimit ndodhet edhe në rrethanat e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, çka lidhet me mungesën e gatishmërisë për bashkepunim, duke mos përmbushur detyrimet e saj ligjore në këtë proces, të lidhur me nenin 43/3 të ligjit nr. 84/2016. Këto rrethana e çojnë subjektin në përcaktimet edhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Kjo është fryma që përcjell edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në një numër të konsiderueshëm rastesh, kur ka konkluduar në lidhje me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pikën 5 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 61 ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Majlinda Tosku, ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.2.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar/kundër

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana